1.31.2.kur shenja nga paragrafi 1 pika 31 të këtij nenit vendoset nën shenjen III-84 (emërtimi i zonës urbane), kufizimi i shpejtësisë vlen për tërë territorin e zonës urbane;

1.31.3.numri në shenjë është i dhënë si shembull ndërsa numri i vërtetë shkruhet sipas rrethanave në rrugë dhe nevojave të sigurisë së trafikut.




Shenja II-31

1.32. shenja »ndalim tejkalimi për të gjitha automjete përveç motoçikletës pa rimorkio anësore« (II-32). Kjo shenjë tregon vendin ose pjesën e rrugës ku ndalohet tejkalimi për të gjitha automjete përveç motoçikletës pa rimorkio anësore dhe mjeteve të cilat në rrugë të rrafshët nuk mund të zhvillojnë shpejtësi më të madhe se 30 km/h si dhe mjetet të cilat nuk konsiderohen automjete. Simboli i automjetit të udhëtarëve së majtë në shenjë është me ngjyrë të kuqe;



Shenja II-32

1.33. shenja » ndalim tejkalimi për mjetet transportuese -kamionë « (II-33) tregon vendin ose pjesën e rrugës ku ndalohet tejkalimi për mjetet transportuese masa më e madhe e lejuar është mbi 3.5 tona, përveç motoçikletës pa rimorkio anësore dhe mjetet të cilat në rrugë të rrafshët nuk mund të zhvillojnë shpejtësi më të madhe se 30 km/h si dhe mjetet të cilat nuk konsiderohen automjete:

1.33.1. nëse në shenjën nga nënparagrafi 1 pika 33 të kësaj shtojce është shtuar tabela plotësuese në të cilën është shënuar masë më e madhe e lejuar (p.sh 5 t) ndalesa ka të bëjë për ato mjete transportuese tek të cilat masa më e madhe e lejuar tejkalon masën e caktuar;

1.33.2. në shenjë simboli i mjetit transportues është me ngjyrë të kuqe.



Shenja II-33

1.34. shenja »ndalim kalimi pa u ndalur –dogana « (II-34) tregon afërsinë e doganës ku mjeti duhet të ndalet:

1.34.1. fjalia e shkruar në shenjë është »DOGANA – CUSTOMS »;

1.34.2. fjala e shkruar në shenjë tregon arsyen e ndaljes së obliguar.




Shenja II-34

1.35. shenja »ndalim kalimi pa u ndalur « Policia« (II-35) tregon afërsinë e policisë ku mjeti duhet të ndalet:

1.35.1. fjalia e shkruar në shenjë është »POLICIJA – POLICE »;

1.35.2. fjala e shkruar në shenjë tregon arsyen e ndaljes së obliguar.




Shenja II-35

1.36 shenja »ndalim kalimi pa u ndalur pagesa rrugore « (II-36) tregon afërsinë e vendit ku mjeti duhet të ndalet për të paguar pagesën rrugore. Kjo shenjë mund të përdoret për shënimin e afërsisë të vendeve tjera në të cilën mjetit duhet të ndalet. Në këtë rast mbishkrimi në shenjë pagesa rrugore (II-36) zëvendësohet me mbishkrim përkatës më të cilin tregohet arsyeja e ndaljes së obliguar. Fjala e shkruar në shenjë tregon arsyen e ndaljes së obliguar;




Shenja II-36

1.37. shenja »ndalimi i dhënies së shenjave akustike (zërit) « (II-37) tregon rrugën ose pjesën e rrugës ku ndalohet dhënia e shenjave akustike, përveç në rast të rrezikut të drejtpërdrejtë;



Shenja II-37

1.38. shenja »përparësi kalimi për mjetet nga kahja e kundërt « (II-38) tregon ndalimin e hyrjes së mjetit në pjesën e ngushtë të rrugës para se të kalojnë mjetet nga kahu i kundërt:

1.38.1. simboli në shenjë ka shigjetën me ngjyrë të kuqe e cila tregon kahun i cili nuk ka përparësi;

1.39.2. shenja vendoset në vende nga i cili shihet pjesa e rrugës për të cilën ka të bëjë ndalimi.



Shenja II-38

1.39. shenja »ndalim ndalje dhe parkimi « (II-39) tregon anën e rrugës ku është e ndaluar ndalja dhe parkimi i mjetit:

1.39.1. ngjyra bazë e shenjës është e kaltër;

1.39.2. shenja mund të ketë tabelën plotësuese të vizatuar me shigjeta të cilat vendosen nën shenjë paralelisht me aksin gjatësor të rrugës, e cila tregon në atë ndalesë, përkatësisht kufizimin e shënuar me shenjë të trafikut, dhe ka të bëjë vetëm me pjesën e rrugës e cila shtrihet në drejtim të shigjetës dhe në distancë e cila është e shënuar pranë.



Shenja II-39

1.40. shenja » ndalim parkimi « (II-40) tregon anën e rrugës ku është i ndaluar parkimi i

mjetit, ndërsa lejohet-ndalja:

1.40.1. ngjyra bazë e shenjës është e kaltër;

1.40.2. shenja mund të ketë tabelën plotësuese të vizatuar me shigjeta të cilat vendosen nën shenjë paralelisht me aksin gjatësor të rrugës , e cila tregon në atë ndalesë, përkatësisht kufizimin e shënuar me shenjë të trafikut dhe ka të bëjë vetëm me pjesën e rrugës e cila shtrihet në drejtim të shigjetës dhe në distancë e cila është e shënuar pranë.



Shenja II-40

1.41. shenja »parkimi alternativ « (II-41), tregon anën e rrugës ku është e ndaluar parkimi në ditët tek. Ngjyra bazë e shenjës është e kaltër ndërsa simboli me ngjyrë të bardh;



Shenja II-41

1.42. shenja »parkimi alternativ « (II-42) tregon anën e rrugës ku është e ndaluar parkimi në ditët çift. Ngjyra bazë e shenjës është e kaltër ndërsa simboli me ngjyrë të bardh;



Shenja II-42

1.43. shenja » ndalim fotografimi « (II-43 ) tregon hapësirën pranë rrugës në të cilën është e ndaluar fotografimi, incizimi, skicimi e ngjashëm;



Shenja II-43

2. Shenjat e urdhrave të prera pjesëmarrësve në trafik iu bënë me dije për obligimet si vijon:

2.1. shenja » shpejtësia më e vogël e lejuar » (II-44) tregon rrugën ose pjesën e rrugës në të cilin mjetet në kushtet normale duhet të lëvizin së paku me atë shpejtësi (km/h) e cila është e përcaktuar me shenjë. Numri në këtë shenjë është i dhënë si shembull. Shpejtësia më e vogël e lejuar përcaktohet me shenjë varësisht sipas kushteve të rrugës dhe nevojave për sigurinë e trafikut;




Shenja II-44

2.2. shenja » pajisje dimërore» (II-45) tregon pjesën e rrugës në të cilin automjete përveç motoçikletave duhet të kenë pajisje dimërore të parapara gjatë kushteve dimërore;



Shenja II-45

2.3. shenja »shtegu i biçikletave» (II-46) tregon shtegun në të cilën duhet të lëvizin biçikletat;



Shenja II-46

2.4. shenja »shtegu i këmbësorëve » (II-47) tregon shtegun e këmbësorëve të ndërtuar në të cilën këmbësorët duhet të lëvizin, ndërsa ju ndalohet lëvizja pjesëmarrësve tjerë në trafik;



Shenja II-47

2.5. shenja » shtegu i këmbësorëve dhe biçikletave » (II-48) tregon shtegun e këmbësorëve dhe biçikletave të ndërtuar në të cilën këmbësorët dhe biçiklistët duhet të lëvizin, ndërsa ju ndalohet lëvizja pjesëmarrësve tjerë në trafik. Me vijë të bardhë në sipërfaqen e shtegut është e ndarë sipërfaqja për këmbësorë nga sipërfaqja për biçikleta;



Shenja II-48

2.6. shenja » shtegu për kalorës » (II-49) tregon shtegun në të cilin duhet të lëvizin kalorësit, ndërsa ju ndalohet lëvizja pjesëmarrësve tjerë në trafik;



Shenja II-49

2.7. shenja » kahe e obliguar » (II-50), (II-51), (II-52), (II-53), (II-54) dhe (II-55) tregon kahet në të cilat mjeti duhet të lëviz;

2.7.1. shenjat vendosen në kryqëzim;

2.7.2. shenjat (II-50), (II-51) dhe (II-52) vendoset në vendin ku fillon obligimi për kthim të mjetit, ndërsa shenjat (II-53), (II-54) dhe (II-55) vendosen para vendit kur fillon obligimi për kthim të mjetit.



Shenja II-50



Shenja II-51



Shenja II-52



Shenja II-53



Shenja II-54



Shenja II-55

2.8. shenjat »kahet e lejuar» (II-56), (II-57) dhe (II-58) shënon kahet në të cilat mjeti mund të lëviz;



Shenja II- B56



Shenja II-57



Shenja II-58

2.9. shenja » anashkalim i obliguar nga ana e djathtë » ( II-59), » anashkalim i obliguar nga ana e majtë » ( II-60), » anashkalimet e obliguar » (II-61) dhe » trafikun me rrethrrotullim » ( II-62) tregon rrugën ose pjesën e rrugës në të cilën mjetet duhet të lëvizin gjatë anashkalimit të ishullit të këmbësorit, ishullit për orientimin e trafikut dhe objektet tjera në rrugë ose të lëviz në rrethrrotullim. Shenjat vendosen në maje ose skaje të ishullit të këmbësorëve përkatësisht ishujt për orientimin e trafikut ose para objekteve

tjera në rrugë.



Shenja II-59



Shenja II-60



Shenja II-61



Shenja II-62





SHTOJCA III

## SHENJAT E LAJMËRIMIT

1. Shenjat e lajmërimit janë:

1.1. shenja » përparësi kalimi në raport me mjetet nga kahu i kundërt « (III-01) paralajmëron shoferin që në pjesën e ngushtë të rrugës ka përparësi kalimi ndaj mjeteve që vijnë nga kahu i kundërt. Kur përdoret shenja III-01, në hyrje të pjesës së ngushtë të rrugës nga kahu i kundërt duhet të vendoset shenja »përparësi kalimi për mjetet nga kahu i kundërt« (II-38);



Shenja III-01

1.2. shenja »vendkalimi i shënuar për këmbësor « (III-02) dhe »vendkalimi i shënuar për shtegun e biçikletave« (III-03), dhe vendkalimi i shtegut për këmbësor dhe për biçikleta (III-04), tregon vendin në rrugë në të cilën gjendet vendkalimi i shënuar për këmbësor, përkatësisht vendkalimi i shtegut për biçikleta ose vendkalimi i shtegut për këmbësor dhe biçikleta:

1.2.1. Shenja punohet së paku me klasë të II-të retroreflektive;

1.2.2. shenjat vendosen drejtpërsëdrejti para vendkalimit të shënuar për këmbësor përkatësisht biçikletave.



Shenja III-02



Shenja III-03



Shenja III-04

1.3. shenja "fëmijët në rrugë " (III-05), tregon vendin në cilën fëmijët lëvizin shpesh ose në numër të madhe (p.sh para shkollave, fushave sportive, çerdheve të fëmijëve, e hapësirave të ngjashëme). Shenja punohet së paku me klasë të II-të retroreflektive;



Shenja III-05

1.4. shenja » nënkalim ose mbikalimi për këmbësor« (III-06), shenja vendoset vetëm drejtpërsëdrejti para vendit të shënuar për këmbësor, përkatësisht mbi te;



Shenja III-06

1.5. shenja » rruga me trafik në një drejtim« (III-07) dhe (III-08) paralajmëron pjesëmarrësit në trafik për rrugën me një drejtim. Mund të shkruhet mbishkrim në vetë shenjën - shigjetën " një drejtim":

1.5.1. shenja vendoset përgjatë rrugës me trafik një drejtim dhe atë në vendin në të cilën shoferi i cili lëvizë rrugës, përkatësisht i cili hynë në rrugën ne një drejtim, është e nevojshme që të lajmërohet për trafik ne një drejtim;

1.5.2. shenja III-07 vendoset ashtu që shigjeta është në pozitë vertikale përgjatë aksit të rrugës, ndërsa shenja III-08 ashtu që shigjeta është tërthorazi me aksin gjatësor të rrugës.



Shenja III-07



Shenja III-08

1.6. shenja »rrugë me përparësi kalimi« (III-09) tregon rrugën ose pjesën e saj në të cilën mjetet kanë përparësi kalimi ndaj mjeteve të cilat lëvizin në rrugën e cila kryqëzohet me atë rrugë ose pjesën e saj:

1.6.1. shenja ka katrorin me ngjyrë të verdhë, ndërsa hapësira ndërmjet katrorit të brendshëm dhe skajit të jashtëm të shenjës është me ngjyrë të bardhë;

1.6.2. shenja vendoset, sipas rregullave në rrugët kryesore në zonë urbane dhe në hyrje të zonës urbane dhe atë para kryqëzimit.



Shenja III-09

1.7. shenja »mbarim i rrugës me përparësi kalimi « (III-10) tregon vendin në të cilën përfundon rruga ose pjesa e rrugës me përparësi kalimi. Shenja e ka katrorin me ngjyrë të verdhë, ndërsa hapësira ndërmjet katrorit të brendshëm dhe skajit të jashtëm të shenjës është me ngjyrë të bardhë;



Shenja III-10

1.8. shenja »gunga në rrugë« (III-11) tregon vendin ku vendosen pajisjet për ngadalësimin e trafikut. Shenja punohet së paku me klasë të II-të retrorefleksive;



Shenja III-11

1.9. shenja »mbarim i tejkalimit« (III-12), tregon vendin ku mbaron ndalimi i tejkalimit për të gjitha automjeteve përveç motoçikletave pa rimorkio anësore. Shenja vendoset në rrugë në vendin prej ku mbaron ndalimi i tejkalimit për të gjitha automjetet, përveç motoçikletave pa rimorkio anësore;



Shenja III-12

1.10. shenja »ndalim tejkalimi për mjetet transportuese - kamionëve « (III-13) tregon vendin ku mbaron ndalimi i tejkalimit të mjeteve transportuese me masën ma të madhe të lejuar mbi 3.5 tona. Shenja vendoset në rrugë në vendin prej ku mbaron ndalimi i tejkalimit për mjetet transportuese;



Shenja III-13

1.11 shenja »mbarimi i kufizimit të shpejtësisë« (III-14) tregon vendin ku mbaron kufizimi i shpejtësisë, ndërsa shenja »mbarim i shpejtësisë më të vogël të lejuar« (III-15), tregon vendin ku mbaron shpejtësia më e vogël e lejuar:

1.11.1. shpejtësia e dhënë në figurë është marr vetëm si shembull;

1.11.2. shenja vendoset në rrugë në vendin ku mbaron kufizimi i shpejtësisë;




Shenja III-14




Shenja III-15

1.12. shenja » mbarimi i ndalimit të dhënies së shenjave akustike - zërit« (III-16) tregon vendin ku mbaron ndalimi i dhënies së shenjave akustike;



Shenja III-16

1.13. shenja »mbarimi i të gjithave ndalesave« (III-17) tregon vendin në rrugë ku mbarojnë të gjitha ndalesat- kufizimet të cilat më parë kanë qenë të vendosura në atë rrugë apo në një pjesë të rrugës;



Shenja III-17

1.14. shenja » mbarimi i ndalimit të përdorimit të pajisjeve dimërore« (III-18), shenja »mbarimi i shtegut për biçikleta« (III-19), shenja »mbarimi i shtegut për këmbësorë « (III-20) dhe »mbarimi i shtegut për kalorës« (III-21) tregon vendin në rrugë ku mbarojnë ndalimet e caktuar të parapara me shenjat e trafikut të cilat janë të vendosura në atë rrugë;



Shenja III-18



Shenja III-19



Shenja III-20



Shenja III-21

1.15. shenja »zona ku është e kufizuar shpejtësia« (III-22) tregon hapësirën, përkatësisht zonën në të cilën mjetet nuk lejohen të lëvizin (km/h) më të madhe se ajo që parashihet me shenjë;




Shenja III-22

1.16. shenja » mbarim i zonës ku është e kufizuar shpejtësia« (III-23) tregon vendin ku

mbaron kufizimi i shpejtësisë. Shenja përbëhet nga vënia e shenjave përkatëse dhe është e kryqëzuar me pesë vija të pjerrëta me ngjyrë të zezë;




Shenja III-23

1.17. shenja »zona e këmbësorëve « (III-24) tregon hapësirën e paraparë për lëvizjen e këmbësorëve, i ndalohet lëvizja e të gjitha mjeteve me veprim motorik;




Shenja III-24

1.18. shenja » mbarim i zonës së këmbësorëve « (III-25) tregon vendin ku mbaron zona e këmbësorëve;




Shenja III-25

1.19. shenja »zona e trafikut të qetë « (III-26) tregon vendin në zonë urbane në të cilën hynë në zonën në të cilën nuk lejohet të lëvizin më shpejtësi më të madhe se 5 km/h sepse lojërat e fëmijëve janë të lejuar në tërë zonën;



Shenja III-26

1.20. shenja » mbarim i zonës së trafikut të qetë « (III-27) tregon vendin ku dilet nga zona e trafikut të qetë;



Shenja III-27

1.21. shenja »zona ku është kufizuar kohëzgjatja e parkimit« (III-28) tregon vendin në zonë urbane ku hynë në zonën në të cilën është e paraparë kufizimi i përgjithshëm i kohëzgjatjes së parkimit në kohë të caktuar, pa marrë parasysh se është me pagesë ose kompensimi për parkim në kohë të caktuar apo jo. Shenjës mund ti bashkëngjitet tabela plotësuese e cila tregon ditët ose orën për të cilat vlen kufizimi;




Shenja III-28

1.22. shenja » mbarimi i zonës ku është kufizuar kohëzgjatja e parkimit« (III-29) tregon vendin në zonë urbane ku del nga zona në të cilën është i paraparë kufizimi i përgjithshëm i kohëzgjatjes së parkimit në kohë të caktuar. Shenja përbëhet nga vënia e shenjës përkatëse të trafikut dhe është e kryqëzuar me pesë shirita të pjerrët më ngjyrë të zezë;




Shenja III-29

1.23. shenja »zona e shkollës« (III-30) tregon vendin ku fillon zona e shkollës;




Shenja III-30

1.24. shenja » mbarimi i zonë së shkollës« (III-31) tregon vendin ku mbaron zona e shkollës;



Shenja III-31

1.25. shenja »shpejtësia që rekomandohet« (III-32) tregon shpejtësinë e cila rekomandohet në pjesën e caktuar të rrugës. Shpejtësia në shenjë është e dhënë si shembull;




Shenja III-32

1.26. shenja » mbarimi i shpejtësisë që rekomandohet« (III-33) tregon vendin ku mbaron rekomandimi i shpejtësisë në pjesën e caktuar të rrugës. Shpejtësia në shenjë është e dhënë si shembull;



Shenja III-33

1.27. shenja » patrulla shkollore« (III-34) lajmëron shoferët për afërsinë e vendit ose

vendin në të cilën pjesëtarët e njësive shkollore të trafikut sigurojnë kalimin e fëmijëve përtej rrugës ose ne vendkalimin e shënuar për këmbësorë;



Shenja III-34

1.28. shenja »Spitali« (III-35) tregon afërsinë e spitalit dhe i paralajmëron shoferët që me mjetin mos krijon zhurmë të madhe;



Shenja III-35

1.29. shenja »institucioni i ndihmës së shpejtë mjekësore « (III-36) tregon afërsinë ose vendin në të cilën gjendet institucioni i ndihmës së shpejtë mjekësorë. Simboli në shenjë është me ngjyrë të kuqe;


Shenja III-36

1.30. shenja »stacioni policor « (III-37) tregon afërsinë ose vendin ku gjendet stacioni policor;




Shenja III-37

1.31. shenja »parkimi« (III-38) »garazha« (III-39) »parkimi me kohë të kufizuar« (III-40) tregon hapësirën e cila është e përcaktuar ose posaçërisht e ndërtuar për parkimin e mjeteve, përkatësisht grazhdimin e mjeteve. Në shenjën III-38 ose në tabelën plotësuese mundet me simbole përkatëse ose mbishkrime të tregohet, kahun ku gjendet parkimi, distanca në metër deri te parkimi, kategorinë e mjeteve për të cilat është e paraparë parkimi, dhe mundësia e kufizimit me kohëzgjatje të parkimit III-40;




Shenja III-38




Shenja III-39




Shenja III-40

1.32. shenja »telefoni« (III-41) tregon afërsinë e vendit ose vendin ku gjendet kabina e telefonit. Nëse shenja vendoset në tunel, nën fushën e bardhë shkruhet mbishkrimi SOS;



Shenja III-41

1.33. shenja »pika e karburanteve « (III-42) tregon afërsinë e vendit ku gjendet pika e karburanteve;



shenja III-42

1.34. shenja »informatat « (III-43) tregon afërsinë e vendit ose vendin në të cilën mund të merren informata të nevojshme ( turistike, etj);



Shenja III-43

1.35. shenja »telefoni« (III-44) tregon afërsinë e vendit ose vendin ku gjendet hoteli ose moteli;



Shenja III-44

1.36. shenja »restoranti« (III-45) tregon afërsinë e vendit ose vendin ku gjendet restoranti;



Shenja III-45

1.37. shenja » uji i pijshëm « (III-46) tregon afërsinë e vendit ose vendin ku gjendet ujit e pijshëm;



Shenja III-46

1.38. shenja »vend ndalje e autobusëve « (III-47) tregon vendin ku gjendet vend ndalja e autobusit. Shenja vendoset në pjesën dalëse të vend ndaljes e cila është paralelisht me aksin gjatësorë të rrugës, shikuar në kahe të lëvizjes;



Shenja III-47

1.39. shenja »vend ndalje e tramvajit « (III-48) tregon vendin ku gjendet vend ndalja e tramvajit. Shenja vendoset në pjesën dalëse të vend ndaljes e cila është paralelisht me aksin gjatësorë të rrugës, shikuar në drejtim të lëvizjes;



Shenja III-48

1.40. shenja »taxi « (III-49) tregon vendin ku gjendet vend ndalja e taksistëve. Shenja vendoset në pjesën dalëse të vend ndaljes e cila është paralelisht me aksin gjatësorë të rrugës, shikuar në kahun të lëvizjes;




Shenja III-49

1.41. shenja »aeroporti« (III-50) tregon afërsinë e aeroportit ose vendin e aeroportit;



Shenja III-50

1.42. shenja »porti-limani« (III-51) dhe (III-52) tregon afërsinë e portit, limanit, përkatësisht trajektin, ose vendin ku gjendet porti, limani ose trajekti;



Shenja III-51



Shenja III-52

1.43. shenja »marina« (III-53) tregon afërsinë e vendit ose vendin ku gjendet porti për lundrime turistike dhe sportive;



Shenja III-53

1.44. shenja »kafeneja« (III-54) tregon afërsinë e vendit ose vendin ku gjendet kafeneja;



Shenja III-54

1.45. shenja »vendi për lëshuarën e ujërave të mbeturinave (ndotura, të zeza etj) « (III-55) tregon vendin ku hedhen ujërat të mbeturinave nga mjeti për kamping;



Shenja III-55

1.46. shenja »tereni për kamping nën shator « (III-56) »tereni për kamping me rimorkio« (III-57) ) dhe »teren për kamping në mjet (III-58), tregon afërsinë e terrenit ose terrenin e ndërtuar për kamping nën shator, qëndrimin në rimorkio ose në mjet. Shenjat munden të kombinohen ndërmjet veti sipas destinimit të terrenit për kamping;



Shenja III-56



Shenja III-57



Shenja III-58

1.47. shenja »tereni i ndërtuar për piknik « (III-59) shënon afërsinë e terrenit ose terrenin e ndërtuar për piknik;



Shenja III-59

1.48. shenja »shtëpia malore « (III-60) shënon afërsinë e vendit ose vendin ku gjenden shtëpitë malore dhe ternin e ndërtuar për piknik;



Shenja III-60

1.49. shenja » aparati për shuarjen e zjarrit« (III-61), tregon afërsinë e vendit ose vendin

ku gjendet aparati për shuarjen e zjarrit ose shërbimi i zjarrfikëseve;

1.49.1. nëse shenja vendoset para shërbimit të zjarrfikëseve, nën fushën bardhë shkruhet »ZJARRFIKËSET«;

1.49.2. simboli në shenjë është me ngjyrë të kuqe;



Shenja III-61

1.50. shenja » mjeti për ndihmë në rrugë« (III-62), tregon afërsinë e vendit ose vendin ku gjendet shërbimi për afrimin e ndihmës në rast defektit në mjet;



Shenja III-62

1.51. shenja »punëtoria për riparimin e mjetit« (III-63), tregon afërsinë e vendit ku gjendet punëtoria për riparimin e mjetit;



Shenja III-63

1.52. shenja »autolarja për mjete« (III-64), tregon afërsinë e vendit ku gjendet autolarja;



Shenja III-64

1.53. shenja »WC-« (III-65) tregon afërsinë e vendit ku gjenden wc publike;




Shenja III-65

1.54. shenja »punëtoria për riparimin e gomave« (III-66) tregon afërsinë e vendit ku gjendet punëtoria për riparimin e gomave;



Shenja III-66

1.55. shenja »radiostacioni« (III-67) tregon hapësirën ku mund të dëgjohet radiostacioni për gjendjen e rrugëve, ku emërtimi dhe frekuencat e vendit janë të shënuar në shenjë;




Shenja III-67

1.56. shenja »hapësira ujëmbrojtëse « (III-68), tregon vendin në rrugë ku rruga shtrihet nën hapësirën e mbrojtjes të ujit dhe ku shoferët duhet të jenë të kujdesshëm. Simboli në shenjë është me ngjyrë portokalltë, përkatësisht aksi i mjetit me ngjyrë të zezë, dy vija valore me ngjyrë të kaltër;



Shenja III-68

1.57. shenja »auto udha« (III-69) tregon vendin kur fillon auto udha;



Shenja III-69

1.58. shenja » përfundimi i auto udhës« (III-70) tregon vendin ku përfundon auto udha;



shenja III-70

1.59. shenja »moto udha« (III-71) tregon vendin ku fillon moto udha;



Shenja III-71

1.60. shenja »mbarimi i moto udhës « (III-72) tregon vendin ku mbaron moto udha. Shenja është e kryqëzuar me vijë të pjerrtë ngjyrë të kuqe;



Shenja III-72

1.61. shenja »rrugë pa dalje« (III-73) tregon afërsinë dhe pozitën e rrugës e cila nuk ka

dalje. Pozita e simbolit në shenjë duhet ti përgjigjet pozitës reale të rrugës pa dalje ndaj rrugës në të cilën vendoset shenja;



Shenja III-73

1.62. shenja »kthimi majtas inderekt« (III-74) tregon rrugën në të cilën mjeti duhet të lëvizë deri te ky kryqëzim. Shenja vendoset në kryqëzimin e parë para atij në të cilën është i ndaluar kthimi majtas;



Shenja III-74

1.63. shenja »vendi për ndalje të dhunshme të mjetit « (Shenja III- 75/ III-76) tregon vendin ose afërsinë e vendit në të cilën është e ndërtuar sipërfaqja e veçantë në rrugë për ndalje të dhunshme:

1.63.1. shenja vendoset në fillim të zgjerimit në 250 metra, por mundet edhe në 150 metra para vendit të shënuar;

1.63.2. shenja III-73 ka mbishkrimin SOS në shtresën e kuqe;

1.63.3. shenja III-73 vendoset në zgjerimin në të cilën gjendet SOS telefoni, shenja III-74 vendoset në zgjerimin në afërsi të cilës nuk ka SOS telefon;

1.63.4. ngjyra e shenjës varet nga lloji i rrugëve në të cilën vendoset rruga.




Shenja III-75



Shenja III-76

1.64. shenja »qafë mali « ( III-77), tregon qaf malin me lartësi mbidetare. Ngjyra e shenjës varet nga lloji i rrugës në të cilën vendoset shenja;




Shenja III-77

1.65. shenja »lumi « ( III-78), tregon emrin e lumit përtej të cilit kalon rruga. Ngjyra e shenjës varet nga lloji i rrugës në të cilën vendoset shenja;




Shenja III-78

1.66. shenja »objektet rrugore « (III-79 dhe III- 80), tregon emrin dhe gjatësinë e objekteve rrugore me rëndësi të veçantë (tunel, viadukt). Ngjyra e shenjës varet nga lloji i rrugës në të cilën vendoset shenja;




Shenja III-79




Shenja III-80

1.67. shenja »stacioni policor« (III- 81), tregon afërsinë e vendit ose vendin ku gjendet stacioni policor. Nën shigjetë mund të shkruhet distanca në metra deri te vendi ku është stacioni policor;




Shenja III-81

1.68. shenja »zonë rurale « (III- 82), tregon emrin e zonës rurale në të cilën hynë rruga dhe kufirin nga ku fillon kjo zonë;




Shenja III-82

1.69. shenja »mbarimi i zonë rurale« (III- 83), tregon vendin ku mbaron zona rurale nëpër të cilën kalon rruga;




Shenja III-83

1.70. shenja »zonë urbane « (III- 84), tregon emrin e zonës urbne në të cilën hynë rruga dhe kufirin nga ku fillon kjo zonë. Shenja vendoset në vendin e hyrjes në zonës urbane dhe shoferët duhet ti zbatojnë rregullat e trafikut të cilat vlejnë për zonë urbane;




Shenja III-84

1.71. shenja » mbarimi i zonë urbane « (III- 85), tregon vendin ku mbaron zona urbane nëpër të cilën kalon rruga. Shenja vendoset në vendin ku mbaron zona urbane dhe mbaron të zbatuarit e rregullave të trafikut që kan vle në zonën urbane;




Shenja III-85

1.72. shenja »udhëtregues« (III- 86), tregon vendin, karakteristikën e objektet ose përmbajtjen kah shtrihet rruga në të cilën udhëtreguesi tregon:

1.72.1. në udhëtregues mund të shkruhen më së shumti dy emra të cilët shkruhen njëri nën tjetrin;

1.72.2. me shenjen III-86 dhe III-87 duhet të shënohet distanca deri te destinacioni në km;

1.72.2. shenjat vendosen në kryqëzim në vendin ku fillon rruga e cila është e paraparë me shenjë;

1.72.3. ngjyra e shenjës varet nga lloji i rrugës në të cilën vendoset shenja;

1.72.4. shenja III-86 dhe III-87 mund të vendoset në shkallën e katërt të largësisë së udhëheqjes të trafikut.




Shenja III-86




Shenja III-87

1.73. shenja « udhëtregues për aeroport « (III-88) tregon drejtimin kah aeroporti;




Shenja III-88

1.74. shenja « udhëtregues për auto udhës dhe moto udhë « (III-89 dhe III-90 ) tregon drejtimin kah auto udhë dhe moto udha:

1.74.1. në udhëtregues mund të shkruhen emrat e vendeve, simbolet në auto udhë

përkatësisht në moto udhë dhe shenja në auto udhës përkatësisht në moto udhë;

1.174.2. shenja III-89 vendoset në kryqëzim kur hyhet në auto udhës ose në moto udhë;

1.174.3. shenja III-90 vendoset në kryqëzim e cila shpie ose gjendet në kah të auto udhës ose moto udhës;

1.174.4. ngjyra e shenjës varet nga lloji i rrugës në të cilën vendoset shenja;

1.174.5. shenjat mund të vendosen në shkallën e katërt të largësisë së udhëheqjes të trafikut.



Shenja III-89



Shenja III-90

1.75. shenja « rreshtim i mjeteve « (III-91) dhe » rreshtimi i mjeteve sipas emërtimeve të zonave urbaneve » ( III-92) tregon vendin e rreshtimit në kryqëzim në rrugë me shumë shirita të trafikut:

1.75.1. në shenjë mund të shkruhen emrat e vendeve (III-91);

1.75.2. simbolet në shenja duhet ti përgjigjen numrit të vërtetë të shiritave të trafikut dhe mënyrës së rreshtimit në to;

1.75.3. ngjyra e shenjës varet nga lloji i rrugës në të cilën vendoset shenja.


Shenja III-91




Shenja III-92

1.76. shenja «fillimi i shiritit të trafikut për mjetet e transportit publik të udhëtarëve«(III-93) dhe shenja » përfundimi i shiritit për mjetet e transportit publik të udhëtarëve » ( III-94) tregon vendin në të cilin fillon përkatësisht përfundon shiriti i trafikut për lëvizjen e mjeteve të transportin publik të udhëtarëve;




Shenja III-93




Shenja III-94

1.77. shenja « shiriti i trafikut për mjetet e transportit publik të udhëtarëve «(III-95) shënohet me simbole ose tekst në shiritin e trafikut në të cilin lëvizin vetëm mjetet e transportit publik të udhëtarëve. Në shenjat III-93, III-94 dhe III-95 në vend të simboleve mund të shkruhet teksti »Tram«, »Bus«, »Taxi«;



Shenja III-95

1.78. shenja » hapja e shiritit të trafikut » ( III-96) tregon vendin kur fillon shiriti shtesë i trafikut për lëvizjen e mjeteve në të njëjtin kah:

1.78.1. në shenjë mund të shkruhet distancë deri te vendi kur fillon hapja e shiritit të trafikut;

1.78.2. simboli në shenjë duhet ti përgjigjet numrit të vërtetë të shiritave të trafikut dhe mënyrës së rreshtimit në to;

1.78.3. shenja vendoset në rrugët publike dhe në rrugët tjera;

1.78.4. kur për shkak të pengesave ose të dëmtimeve të rrugës trafiku për një kohë të

caktuar orientohet, shenjat në sipërfaqe kanë ngjyrë të verdhë.



Shenja III-96

1.79. shenja » mbyllja (reduktimi) i shiritave të trafiku » (III-97) tregon vendin kur mbyllet përkatësisht përfundon një shirit i trafikut për lëvizjen e mjeteve në të njëjtin drejtim:

1.79.1. në shenjë mund të shkruhet distanca deri te vendi kur fillon mbyllja e shiritit të trafikut;
1.79.2. simboli në shenjë duhet t'i përgjigjet numrit të vërtetë të shiritave të trafikut dhe mënyrës së rreshtimit në to;
1.79.3. ngjyra e shenjës varet nga lloji i rrugës në të cilën vendoset shenja;
1.76.4. kur për shkak të pengesave ose të dëmtimeve të rrugës, trafiku për një kohë të caktuar orientohet, shenjat në sipërfaqe kanë ngjyrë të verdhë.



Shenja III-97

1.80. shenja »shpejtësia e lejuar në shiritat e caktuar të trafikut» (III-98) tregon shpejtësinë më të vogël të lejuar në shiritat e caktuar të trafikut:

1.80.1. shpejtësia e dhënë në shenjë është marr si shembull;

1.80.2. simboli në shenjë duhet ti përgjigjet numrit të vërtetë të shiritave të trafikut dhe mënyrës së rreshtimit në to;

1.80.3. ngjyra e shenjës varet nga lloji i rrugës në të cilën vendoset shenja.



Shenja III-98

1.81. shenja » shiriti i trafikut për mjetet e ngadalshme » (III-99) tregon vendin kur fillon shiriti në të cilën duhet të lëvizin mjetet e ngadalshme të cilat lëvizin me shpejtësi më të vogël sesa ajo që parashihet me shenjë:

1.81.1. në shenjë mund të shkruhet distanca deri te vendi ku fillon shiriti për mjetet e ngadalshme;

1.81.2. simboli në shenjë duhet ti përgjigjet numrit të vërtetë të shiritave të trafikut, ndalimi dhe mënyra e rreshtimit në to. Shpejtësia e dhënë në shenjë është marrë si shembull;

1.81.3. ngjyra e shenjës varet nga lloji i rrugës në të cilën vendoset shenja dhe mund te ketë simbole të ndryshme.



Shenja III-99

1.82. shenja » mbarimi (mbyllja) i shiritit të trafikut për mjetet e ngadalshme » (III-100) tregon vendin kur mbaron shiriti për mjete e ngadalshme:

1.82.1. në shenja mund të shkruhet distanca deri te vendi i mbarimit të shiritit të trafikut;

1.82.2. simboli në shenjë duhet përgjigjur numrit të vërtetë të shiritave të trafikut dhe mënyrës së rreshtimit në to;

1.82.3. ngjyra e shenjës varet nga lloji i rrugës në të cilën vendoset shenja dhe mund te ketë simbole të ndryshme.



Shenja III-100

1.83. shenja « dalja nga auto udha dhe nga moto udha « (III-101) tregon distancën deri te fillimi i shiritit të trafikut për dalje nga rruga:

1.83.1. ngjyra e shenjës varet nga lloji i rrugëve në të cilën vendoset rruga;

1.83.2. shenja sipas rregullës së vendosur kur shiriti i trafikut për dalje nga auto udha ose nga moto udha është më e vogël sesa gjatësia e paraparë dhe atë në përfundim të auto udhës ose të moto udhës.



Shenja III-101

1.84. shenja »tabela për shënimin e daljes » ( III-102) tregon vendin e daljes nga auto udha ose nga moto udha:

1.84.1. ngjyra e shenjës varet nga lloji i rrugëve në të cilën vendoset shenja;

1.84.2. shenja vendoset në maje të ishullit ndarës.



Shenja III-102

1.85. shenja » pushimorja » (III-103) dhe (III-104) tregon arritjen në vendin ku gjendet vendi i pushimores me përmbajtje të shërbimeve dhe hapësirës për pushimin e udhëtarëve:

1.85.1. në shenjë simbolet përmbajnë vendin e pushimores distancën deri të pushimorja ( III-103) , përkatësisht deri te pika tjetër e karburanteve (III-104);

1.85.2. kur shenja (III-104) vendoset në fillim të shiritit të trafikut për shkyçje, nën simbol të përmbajtjes së vendit të pushimores gjendet shigjeta e pjerrët në të djathtë;

1.85.3. ngjyra e shenjës varet nga lloji i rrugëve në të cilën vendoset shenja.




Shenja III-103




Shenja III-104

1.86. shenja » ndalim i hyrjes të llojit të caktuar të mjeteve në auto udhë ose në moto udhë » (III-104) tregohen cilat lloje te mjeteve dhe pjesëmarrësve në trafik iu ndalohet lëvizja në auto udhë dhe në moto udhë. Kur shenja ka të bëjë me moto udhën shenja përmban shenjën (III-68) dhe është me ngjyrë të kaltërt;




Shenja III-105

1.87. shenja » pagesa rrugore » (III-106) e vendosur mbi shiritin e trafikut tregon afërsinë e objektit ku bëhet pagesa rrugore. Ngjyra e shenjës varet nga lloji i rrugëve në të cilën vendoset shenja;




Shenja III-106

1.88. shenja » lajmërimi për pagesë rrugore »(III-107) tregon afërsinë e objektit ku bëhet pagesa rrugore. Ngjyra e shenjës varet nga lloji i rrugëve në të cilën vendoset shenja;




Shenja III-107

1.89. shenja » marrja e obligueshme e kartelës për pagesë »(III-108) , » pagesa rrugore » (III-109) » pagesa rrugore elektronike » (III-110) dhe » pagesa rrugore me smartkartelën » (III-111) tregon marrjen e obligueshme të kartës për pagesë përkatësisht mënyrës së pagesës rrugore në objektet ku bëhet pagesa rrugore. Ngjyra e shenjës varet nga lloji i rrugëve në të cilën vendoset shenja;



Shenja III-108




Shenja III-109




Shenja III-110




Shenja III-111

1.90. shenja » parashenja devijim » (III-112) tregon kahun dhe drejtimin e devijimit

nëpërmes zonës urbane. Shenja » parashenja për devijim » tregon kahun dhe drejtimin e devijimit të orientimit të trafikut kur për shkak devijimit të zonës urbane ose dëmtimit të rrugës ku trafiku pjesërisht ose tërësisht është i ndaluar. Te orientimi i mëtutjeshëm i trafikut shenjës duhet ti shtohet tabela plotësuese me mbishkrimin DEVIJIM. – km;




Shenja III-112

1.91. shenja » udhëtregues për devijim » (III- 113) tregon drejtimin e përkohshëm të devijimit:

1.91.1. nëse drejtimi i devijimit është vetëm për këmbësor ose për kategorinë e caktuar të mjeteve, atëherë në anën e majtë të shenjës shënohet simboli i këmbësorit ose lloji i mjetit që parashihet me shenjë;

1.91.2. shenja është më ngjyre portokalli.




Shenja III-113

1.92. shenja » shiriti për mbulimin e shenjave » (III-114) shërben për mbulesën e përkohshme të shenjës së trafikut ose për mbulesën e përkohshme të ndonjë emërtimi të zonë urbane në shenjën e trafikut të lajmërimit për udhëheqjen e trafikut kur nuk është në funksion. Shenja është me ngjyrë portokalli;



Shenja III-114

1.93. shenja »kahu i devijimit për lloje të caktuara të mjeteve » (III-115) dhe (III-116) i njofton shoferët e mjeteve të treguar në shenjë që duhet të ngasin në kahun i cili është i paraparë në shenjën e trafikut – kahu i obliguar;



Shenja III-115



Shenja III-116

1.94. shenja » parashenja për rregullimin e trafikut manual » ( III-117) paralajmëron shoferët për afërsinë e vendit ku kryhen punimet dhe kur trafiku në mënyrë alternative rregullohet. Shenja është me ngjyrë të verdhë;




Shenja III-117

1.95. shenja » shiriti i trafikut i paraparë për llojin e caktuar të mjeteve » (III-118) i cili është me simbolin ose vënë në shenjë të trafikut (III-119) tregon numrin dhe destinimin e shiritave të trafikut, kur për shkak të mbajtjes së rrjedhjes së trafikut në rrugë në zonën ku kryhen punimet, kufizimit kohë shkurt ose dëmtimit të rrugës, trafiku rregullohet në atë mënyrë që shiritat e trafikut janë paraparë për llojin e caktuar të mjeteve etj:

1.95.1. gjerësia e paraqitur në shenjë është marr si shembull;

1.95.2. simboli në shenjë duhet t'i përgjigjet numrit të vërtetë të shiritave të trafikut dhe mënyrës së rreshtimit në to;

1.95.3. ngjyra bazë e shenjës është e bardhë, ndërsa për shkak të pengesave ose dëmtimit të rrugëve trafiku për një kohë të caktuar orientohet, shenjat kanë bazën me ngjyrë të verdhë.






Shenja III-118 Shenja III-119

1.96. shenja » parashenja për orientimin e trafikut në rrugë me ndarje të shiritave të trafikut » (III-120), (III-121), (III-122), (III-123) dhe (III-124) lajmëron dhe tregon kahun, mënyrën e orientimit të trafikut kur për shkak të pengesave ose dëmtimeve të rrugës trafiku në kohë të caktuar orientohet nga një shirit rrugor në shiritin rrugore të paraparë për trafik nga kahu i kundërt, për këtë arsye në kohë të caktuar zhvillohet trafiku në dy drejtime dhe anasjelltas, gjatë kalimit nga trafiku dy kahe në trafik në një kahe:

1.96.1. simboli në shenjë duhet ti përgjigjet numrit të vërtetë të shiritave të trafikut dhe mënyrës së rreshtimit në to;

1.96.2. ngjyra bazë e shenjës është e bardhë, ndërsa për shkak të pengesave ose dëmtimit të rrugëve trafiku për një kohë të caktuar orientohet, shenjat kanë bazën me ngjyrë të verdhë.







Shenja III-120 Shenja III-121






Shenja III-122 ShenjaIII-123



Shenja III-124

1.97. shenja «tabela për shënimin e emërtimit të rrugës« (III-125) i tregon shoferëve dhe këmbësorëve emrin e rrugës në të cilën kalojnë ose hyjnë:

1.97.1. shenja mund të ketë edhe numrin e shtëpisë, bllokut që ka të bëjë;

1.97.2. shenja vendoset në kryqëzim.




Shenja III-125

1.98. shenja » Republika e Kosovës » (III- 126) tregon hyrjen në Republikën e Kosovës;




Shenja III-126

1.99. shenja » kufizimi i shpejtësisë më të madhe të lejuar në rrugët e Kosovës » (III-127) tregon kufizimin e përgjithshëm të shpejtësisë në Kosovë sipas llojit të rrugës dhe obligimi i ndezjes së dritave të shkurta kur mjeti është në trafik;



Shenja III-127

1.100. shenja »auto shenja ndërkombëtare» (III-128). Në shenjë shkruhet shenja e Republikës së Kosovës;



Shenja III-128

1.101. shenja » Për ndalje emergjente » (III-129) dhe shenja » kahu për ndalje emergjente » ( III-129) tregon ndaljen përkatësisht kahu për dalje emergjente në rast rrezikut në tunele ( galeri). Forma e simbolit dhe distanca në shenja III-130 duhet ti përgjigjet llojit të daljes emergjente nga tuneli (galeria);


Shenja III-129



Shenja III-130

1.102. shenja » numri i shenjave për dalje ose nyejve » (III-131) tregon numrin e daljeve ose nyejve te auto udhës përkatësisht të moto udhës. Ngjyra e shenjës varet nga lloji i rrugëve në të cilën vendoset shenja;



Shenja III-131

1.103. shenja »numri i rrugës ndërkombëtare» (III-132) tregon numrin e rrugës ndërkombëtare. Shenja vendoset si shenjë e veçantë, mund të vendoset nën apo mbi shenja tjera të trafikut;




Shenja III-132

1.104. shenja » numri i auto udhës » (III-133) tregon numrin e auto udhës:

1.104.1. shenja është më ngjyrë të gjelbër, simboli për auto udhës është shkronja A dhe skaji i jashtëm është më ngjyrë të bardhë;

1.104.2. shenja vendoset si shenjë e veçantë, mund të vendoset nën apo mbi shenja tjera të trafikut.




Shenja III-133

1.105. shenja » Rruga Nacionale » (N 2) tregon numrin e rrugës nacionale. Vendoset si shenjë e veçantë, mund të vendoset nën apo mbi shenja tjera të trafikut. Shenja vendoset si shenjë e veçantë, mund të vendoset nën apo mbi shenja tjera të trafikut;




Shenja III-134

1.106. shenja » numri i rrugës rajonale » (III- 135) tregon numrin e rrugës rajonale. Vendoset si shenjë e veçantë, mund të vendoset nën apo mbi shenja tjera të trafikut;




Shenja III-135

1.107. shenja » kilometrazhi për auto udhës ose për moto udhë » (III- 136) tregon kilometrat në të cilën shenja është vendosur:

1.107.1. ngjyra e shenjës varet nga lloji i rrugëve në të cilën vendoset shenja;

1.107.2. shenja sipas rregullave vendoset në anën e djathtë të rrugës në kah të lëvizjes.



Shenja III-136

1.108. shenja » për pjesën e rrugës nacionale» (III-137) tregon numrin e rrugës nacionale, numrin e pjesës në kilometra të rrugës nacionale në të cilën është e vendosur shenja e trafikut. Shenja vendoset nga njëra anë e rrugës me dy pjesë të shenjës;



Shenja III-137

1.109. shenja » pjesa e rrugës rajonale » (III-138) tregon numrin e rrugës rajonale, numrin e pjesës së rrugës rajonale dhe kilometrat e pjesës së rrugës në të cilën është vendosur shenja;

1.109.1. shenja vendoset nga njëra anë e rrugës me dy pjesët të shenjës;

1.109.2. numri i rrugës rajonale në shenjë është marr si shembull.



Shenja III-138

2. Në pjesën e shenjës nën fushën e bardhë ( Shenja III-33, III-34 dhe nga III-38 –III-64 ) me simbole ose mbishkrime shënohen emërtimet, lloji, distanca në metër ose kahu në të cilën gjendet vendi, hapësira, pajisjet, ose shërbimet ( kabina SOS , shërbimi i zjarrfikësve, objektet hoteliere dhe ngjashëm ) me të cilën ka të bëjë shenja. Në këtë rast fusha e kaltër nën simbolin e shenjës rritet dhe shenja nga forma e katrorit kalon në formën e katërkëndëshit.

3. Shenjat e lajmërimit për udhëheqjen (drejtuarit ) e trafikut.

3.1. Shenjat e lajmërimit për udhëheqjen e trafikut të shkallës së parë janë:

3.1.1. Shenja »para udhëtregues për dalje nga auto udhë ose nga moto udha« (III-139). Nëse shenja ka të bëjë me auto udhën është me ngjyrë të gjelbër, ndërsa në moto udhë me ngjyrë të kaltër;




Shenja III-139

3.1.2. Shenja » para udhëtregues për nyje të auto udhës me shenjë të nyjës« (III-140). Vendoset në nyje rajonale.




Shenja III-140

3.2. Shenjat e lajmërimit për udhëheqjen e trafikut të shkallës së dytë janë:

3.2.1. shenja »kryqëzim« (III-141) dhe (III-142) tregon pozitën e ndërsjellët, drejtimet e rrugëve, numrin e rrugëve dhe emrat e vendeve ku shpien rrugët të cilat kryqëzohen;

3.2.2. pozita e shigjetave duhet ti përgjigjet pozitës së rrugës në teren;

3.2.3. pozita e shenjës së numrit mbi shigjetë për drejtë mund të jetë majtas ose nën vendin varësisht nga numri i rrugëve dhe numrit të emrave të vendit të cilat janë të nevojshme të shënohen;

3.2.4. pozita e shenjës së numrit të rrugës për majtas dhe djathtas mund të jetë nën drejtim të shigjetës ose nën emërtimin e vendit;

3.2.5. shenjat vendosen në distancë prej së paku 150 metra para kryqëzimit të paraparë me shenjë;

3.2.6. ngjyra bazë e shenjës përcaktohet sipas llojit të rrugës në të cilën vendoset shenja;

3.2.7. për destinacion i cili gjendet në rrugën e llojit tjetër përdoret baza e vënë,

ngjyra e së cilës i përgjigjet lloji të rrugës në të cilën shpie rruga;

3.2.8. shenja III-142 është marrë si shembull, ndërsa pozita reale në rrugë duhet t'i përgjigjet shenjës.



Shenja III-141



Shenja III-142

3.3. Shenja »kryqëzim me rreth rrotullim« (III-143) tregon kryqëzimin në të cilën trafiku zhvillohet me rreth rrotullim:

3.3.1. pozita e shigjetave duhet përgjigjur pozitës së rrugës në teren;

3.3.2. pozita e shenjës të numrit të rrugës mbi shigjetë për drejtë mund të jetë majtas ose nën emërtim të vendit, varësisht nga numri i rrugëve dhe numri i emërtimeve të vendeve të cilat duhet të shënohen;

3.3.3. pozita e shenjës së numrit të rrugës dhe llojit të rrugës majtas dhe djathtas mund të jenë në drejtim të shigjetës ose nën emërtimin e vendit;

3.3.4. shenjat vendosen në distancë prej së paku 150 metra para kryqëzimit të parapara me shenjë;

3.3.5. ngjyra e bazës së shenjës përcaktohet sipas llojit të rrugës në të cilën vendoset shenja. Për destinacion i cili gjendet në rrugën e llojit tjetër përdoret baza e vendosur, ngjyra e së cilës i përgjigjet lloji të rrugës në të cilën shpie rruga.




Shenja III-143

3.4. shenja »tabela para udhëtregues« (III-144), (III-145) dhe (D III-146) tregon emrin e daljes ose ndaljen në auto udhë dhe rrugët në kryqëzime në disnivel, mund të vendoset nga ana e djathtë e rrugës (III-144), (III-145) ose në portal mbi rrugë (III-146)

3.4.1. pozita e shigjetave duhet përgjigjur pozitës së rrugës në teren;

3.4.2. pozita e shenjës të numrit të rrugës mbi shigjetë për drejtë mund të jetë majtas ose nën emërtim të vendit, varësisht nga numri i rrugëve dhe numri i emërtimeve të vendeve të cilat duhet të shënohen;

3.4.3. kur shenja vendoset në portal në shkallën e tretë të lajmërimit, nuk ka fushë të bardhë por distanca deri te dalja shkruhet në fushën e gjelbër para numrit të rrugës nga e cila dilet.

3.5. Shenja III-146 vendoset në nyejt rajonale. Ngjyra e bazës së shenjës përcaktohet sipas llojit të rrugës në të cilën vendoset shenja. Për destinacion i cili gjendet në rrugën e llojit tjetër përdoret baza e vendosur në shenjë, ngjyra e së cilës i përgjigjet lloji të rrugës në të cilën shpie. Shenja III-146 është marrë si shembull, ndërsa pozita reale në rrugë duhet t'i përgjigjet shenjës;




Shenja Shenja III-144




Shenja III-145




Shenja III-146

3.6. Shenjat e lajmërimit për udhëheqjen e trafikut të shkallës së tretë janë:

3.6.1. shenja »para udhëtregues« (III-147) tregon kahun e lëvizjes deri te zona urbane;

3.6.2. ngjyra e bazës për shënimin e kahut të lëvizjes përcaktohet sipas llojit të rrugës në të cilën shpie;




Shenja III-147

3.6.3. shenja »para udhëtregues për dalje« (III-148) dhe (III-148) në auto udhë tregon kahun e lëvizjes deri te zonë urbane të shënuar në shenjë;

3.6.4. ngjyra e bazës për shënimin e kahut të lëvizjes përcaktohet sipas llojit të rrugës në të cilën shpie rruga.




Shenja III-148




Shenja III-149

3.7. Shenjat e lajmërimit për udhëheqjen e trafikut të shkallës të katërt janë:

3.7.1. shenja »tabela udhëtregues« (III-150) tregon kahun e rrugës për zonë urbane të shënuar në shenjë dhe largësinë në kilometra (përveç në fushën e bardhë). Shenja mund ti ketë më së shumti tri fusha për shënimin e kahut të lëvizjes dhe më së shumti dy zonë urbane brenda fushës. Kur shenja vendoset mbi rrugë ( në portal), secila fushë vendoset si shenjë e veçantë mbi shirita të trafikut që parashihet në shenjë:

3.7.1.1. shenja vendoset në kryqëzim në vendin ku fillon rruga që parashihet në shenjë;

3.7.1.2. ngjyra e bazës për shënimin e kahut të lëvizjes përcaktohet sipas llojit të rrugës në të cilën shpie rruga.




Shenja III-150

3.7.2. shenjat »udhëtregues në portal mbi një shiritit të trafikut« (III-151), (III-152) dhe »udhëtregues në portal mbi dy shirita të trafikut« (III-153) dhe (III-154) në auto udhë dhe në rrugë me kryqëzim në disnivel tregon kahun e lëvizjes deri te zona urbane e shënuar në shenjë. Në shenja mund të shkruhen tri, a më së shumti katër emërtime të zonave urbane, përfshirë edhe emrat e parqeve nacionale, qendra olimpike ose ndonjë përmbajte me rëndësi nacionale:

3.7.2.1. shenjat vendosin në hyrje dhe në zona të kryqëzimit në disnivel, dy auto udhë përkatësisht moto udhë në vendin ku fillon shiriti për ngadalësimin e mjetit;

3.7.2.2. ngjyra e bazës së shenjës përcaktohet sipas llojit të rrugës në të cilën shpie. Për destinacion e cila gjendet në rrugët e llojit tjetër, përdoret ngjyra e së cilës është e përaktuar sipas rregullave të sinjalizimit.



Shenja III-151



Shenja III-152



Shenja III-153



Shenja III-154

3.8. Shenjat e lajmërimit për udhëheqjen e trafikut të shkallës së pestë janë:

3.8.1. shenja »vërtetimi i drejtimit« (III-155) tregon vërtetimin e drejtimit të lëvizjes pas kalimit të kryqëzimit;

3.8.1.1. shenja mban emërtimin e vendeve, distancën në kilometra deri te ato vende dhe numrin e rrugëve në të cilën vendi gjendet;
3.8.1.2. pozita e shenjës së numrit të shenjës është në mesë mbi emrin e vendit, përkatësisht nga ana e majtë;
3.8.1.3. në shenjë mund të jetë e shkruar më së shumti pesë emra të vendeve;
3.8.1.4. në auto udhë dhe në moto udhë e cila ka dy shirita rrugor të ndarë shenja vendoset mbi rrugë;
3.8.1.5. shenja vendoset në distancë më së shumti 500 metra prej bashkëngjitjes së fundit;
3.8.1.6. ngjyra e bazës së shenjës përcaktohet sipas llojit të rrugës në të cilën vendoset shenja.



Shenja III-155

**SHTOJCA IV**

## TABELAT PLOTËSUESE

1. Tabelat plotësuese janë:

1.1. tabela plotësuese (IV-01) tregon distancën ndërmjet shenjës në të cilën është e vendosur tabela plotësuese dhe fillimin e pjesës së rrugës, përkatësisht vendit për të cilin ka të bëjë shenja;



Shenja IV-01

1.2. tabela plotësuese (IV -02) tregon distancën (largësinë) deri te vendi në të cilën qëndron shenja II-02 (ndalje e obligueshme) tek te cila shoferi duhet ta ndal mjetin;



Shenja IV -02

1.3. tabela plotësuese (IV -03) tregon gjatësinë e pjesës së rrugës në të cilën kanoset rreziku i paraparë me shenjë, përkatësisht në të cilën zbatohet urdhri i theksuar e paraparë me shenjë, ose në të cilën është paraparë përmbajta e shenjës nga cila rrjedh tabela plotësuese;



Shenja IV-03

1.4. tabela plotësuese ( IV-04) tregon distancën prej shenjës së objektit ose pjesës së

rrugës me të cilën ka të bëjë lajmërimi;




Shenja IV -04

1.5. tabela plotësuese (IV-05) dhe (IV-06) tregon kohën e kufizuar për të cilën vlen urdhri i prerë;




Shenja IV -05




Shenja IV-06

1.6. tabela plotësuese ( IV -07) përmban sqarime të shenjës me fjalë ose në ndonjë mënyrë tjetër nëse nuk është e përcaktuar qartë me simbole në shenjë;




Shenja IV-07

1.7. tabela plotësuese (IV-08) deri (IV-15) përmban simbole për të cilën ka të bëjë shenja;



Shenja IV-08



Shenja IV-09



Shenja IV-10



Shenja IV-11



ShenjaIV-12



ShenjaIV-13



ShenjaIV-14



Shenja IV-15

1.8. tabela plotësuese ( IV-16) tregon largimin e mjetit me »marimang« në vendin ku ndalohet ndalja ose parkimi me rregulla apo me shenja të trafikut;



ShenjaIV-16

1.9. tabela plotësuese ( IV-17) deri ( IV-22) tregon se ndalohet ndalja apo parkimi deri te shenja, prej shenjës, përkatësisht nga njëra ose tjetra anë e shenjës;




Shenja IV-17




Shenja IV-18




ShenjaIV-19



Shenja IV-20



Shenja IV-21



ShenjaIV-22

1.10. tabela plotësuese prej IV-23 deri IV-30 tregon pozitën e parkimit të mjetit. Vendoset me shenjen III-39 (parkimi);



Shenja IV-23



Shenja IV-24



shenja IV-25



Shenja IV-26



shenja IV-27



Shenja IV-28



Shenja IV-29



Shenja IV-30

1.11. shenja plotësuese IV-31 tregon vendin i cili është i rezervuar për mjetet e personave me aftësi të kufizuar ose afërsinë e rrugës ku mund të paraqitet personi me aftësi të kufizuar me karrocë. Vendoset me shenjën I-01 ( rreziku në rrugë) dhe III-39 ( parkimi);



Shenja IV-31

1.12. tabela plotësuese (IV-32) tregon vendin i cili është i rezervuar për shfrytëzuesit e veçantë. Vendoset me shenjën III-39 (parkimi);



Shenja IV-32

1.13. tabela plotësuese (IV-31) dhe (IV-34), tregon fillimin e pjesës së rrugës, përkatësisht vendin ku ekziston rreziku nga shiu i papritur ose nga ngricat. Vendoset me shenjën I-01 ( rreziku i veçantë në rrugë) dhe II-31 (kufizimi i shpejtësisë);


Shenja IV-33


Shenja IV-34

1.14. tabela plotësuese (IV-35) dhe (IV-3) tregon pozitën e rrugës me përparësi kalimi. Tabela plotësuese IV-35 vendoset me shenjën IV-09 ( rruga me përparësi kalimi). Tabela plotësuese IV-36 vendoset me shenjën II-01 ( jep përparësi kalimi) dhe II-02 (ndalje e obligueshme);


Shenja IV-35


Shenja IV-36

1.15. tabela plotësuese ( IV-37) tregon afërsinë e pjesës së rrugës në të cilën mund të shfaqen personat e paftë - të moshuarit;



Shenja IV-37

1.16. tabela plotësuese (IV-38) tregon e afërsinë e pjesës së rrugës në të cilën mund të shfaqin personat e verbër;



Shenja IV-38

1.17. tabela plotësuese (IV-39) tregon e afërsinë e pjesës së rrugës në të cilën bëhet pastrimi i borës. Tabela plotësuese është e përkohshme dhe vendoset gjatë kohës së kryerjeve të punimeve për mirëmbajtjen e rrugëve (pastrimin i borës);



Shenja I-39

1.18. tabela plotësuese (IV-40) lajmëron se në rrugë kryhen punimet në lidhje me vendosjen e shenjave në rrugë. Vendoset me shenjen I-01 ( rreziku në rrugë), II-31 (kufizimi i shpejtësisë). Ngjyra bazë e tabelës plotësuese është e bardhë, simboli i përhimët. Tabela plotësuese është e përkohshme dhe vendoset gjatë kryerjes së punimeve për mirëmbajtjen e rrugëve (vendosja e shenjave në rrugë);



Shenja IV-40

1.19. tabela plotësuese IV-41 tregon afërsinë e vendit në rrugë ku ndodhin aksidentet në komunikacion. Vendoset me shenjën I-01 (rreziku në rrugë), II-31 (kufizim i shpejtësisë). Tabela plotësuese është e përkohshme dhe vendoset në rast të aksidenteve të rënda të trafikut kur rregullohet përkohësisht trafiku;



Shenja IV-41

1.20. tabela plotësuese (IV-42) lajmëron që gjatë kohës së migrimit të bretkosave në numër të madh, kalojnë përtej rrugës që për shoferët paraqesin rrezik të caktuar. Tabela

plotësuese sipas rregullave, vendoset me shenjën I-01 ( rreziku në rrugë);



Shenja IV-42

1.21. tabela plotësuese IV-43 lajmëron që shenja e trafikut të cilës ju është shtuar tabela plotësuese e vendosur për shkak gjurmë mjetesh në rrugë. Vendoset me shenjën I-01 ( rreziku në rrugë), II-31 (kufizimi i shpejtësisë);




Shenja IV-43

1.22. tabela plotësuese (IV-44) tregon vendin në rrugë ku gjendet pajisja për ngadalësimin e trafikut (gungat). Vendoset me shenjën I-34 (afërsia e fëmijëve në rrugë) dhe III-05 ( fëmijët në rrugë);



Shenja IV-44

1.23. tabela plotësuese IV-45 tregon pikën e karburanteve me plin. Vendoset me shenjën III-40 ( pika e karburanteve);




Shenja IV-45

1.24. tabela plotësuese »shenja dalja nga auto udha ose nga moto udha« (IV-46) tregon

afërsinë e daljes nga autoudha ose nga moto udha;



Shenja IV-46

1.25. shenja »shenja e nyjës të auto udhës« (IV-47) tregon afërsinë e kryqëzimit të auto udhës ose moto udhës;



Shenja IV-47

1.26. tabela plotësuese (IV-48) tregon kalimin për mjetet transportuese me ngarkesë përtej gabariteve;



Shenja IV-48

1.27. tabela plotësuese (IV-49) tregon hapësirën me rritjen e koncentrimit të materieve të rrezikshëm në ajër. Ngjyrë bazë e tabelës plotësues është e bardhë, me simbole me rreth ngjyrë të kuqe me mbishkrim me ngjyrë të zezë;




Shenja IV-49

1.28. tabela plotësuese (IV-50) tregon s'kyçen e nevojshme të motorit për shkak pritjeve të gjata për mbrojtjen e ambientit. Ekskluzivisht është e ndërlidhur me punën e sinjaleve të kuqe të semaforëve. Ngjyra bazë e tabelës është e bardhë, me simbole me çelës me ngjyrë të përhimët dhe me mbishkrim me ngjyrë të zezë. Tabela plotësuese vendoset ku është rritja e koncentrimit të materieve të rrezikshme në ajër.




Shenja IV-50

**SHTOJCA V**

## SEMAFORËT

1. Domethënia e semaforit është:

1.1. drita e kuqe nënkupton ndalim kalimi për mjete fig. V-01;

1.2. drita e kuqe dhe e verdhë tregon së shpejti ndërprerje të ndalim trafikut para paraqitjes së dritës së gjelbër fig. V-02;

1.3. drita e gjelbër tregon kalim të lirë të mjeteve, dhe duhet të jetë e ndezur si dritë e pavarur. Kalimi nga drita e gjelbër në të verdhë, duhet të sinjalizohet me ndërprerje të dritës së gjelbër tri herë fig.V-03;

1.4. drita e verdhë para dritës së kuqe nënkupton ndalim lëvizje përveç mjeteve të cilat në momentin kur drita e verdh ndizet, gjenden në atë largësi nga shenja ndriçuese që nuk mund të ndalen në mënyrë të sigurt, e që mos të kalojnë këtë shenjë fig. V-04;

1.5. shigjeta ndriçuese plotësuese (shtesë) tregon kalimin e lirë për mjete në kahun e shënuar me dritë të gjelbër edhe gjatë kohës kur është ndezur drita e kuqe ose e verdhë fig.V-05 dhe V-06;

1.6. format e shigjetave të paraqitura në fig. V-07 (për shigjetat me ndriçim të kuq) dhe V-08 (për shigjetat me ndriçim të gjelbër);

1.7. vijat e kryqëzuara me ngjyrë të kuqe (X), tregojnë ndalimin e trafikut përgjatë shiritit të trafikut të shiritit mbi të cilin është vendosur shenja fig. V-09;

1.8. shigjeta e gjelbër me maje e kthyer teposhtë, tregon kalim të lirë përgjatë shiritit të trafikut mbi të cilën është vendosur shenja fig. V-10;

1.9. shigjeta e verdhë me maje të kthyer nga e djathtë ose e majtë tregon kalimin e rrjedhës së trafikut nga shiriti i trafikut mbi të cilën është i vendosur shenja në shirit tjetër fig. V-11 dhe V-12;

V-01  V-02  V-03  V-04  V-05  V-06





V-07



V-08



V-09



V-10



V-11



V-12

2. Nëse me semafor rregullohet trafiku i biçiklistve në vendkalimin e shtegut të biçikletave përtej rrugës, dritat në semafor janë në formë të siluetës të biçikletës dhe kanë domethënien:

2.1. kalim i lirë për biçiklist –fig. V-13;

2.2. ndalim kalimi për biçiklist –fig. V-14;

2.3. e njëjta pajisje për dhënien e shenjave ndriçuese për biçiklist dhe këmbësorë mund të aplikohet edhe në raste kur shigjeta e këmbësorëve dhe e biçiklistve janë njëra pranë tjetrës -foto V-15 dhe fig. V-16.






V-13 V-14 V-15 V-16

3. Shenjat ndriçuese në semaforë kanë domethënie si vijon:

3.1. kalim i lirë për këmbësorë –fig. V-17;

3.2. ndalim i kalimit për këmbësorë –fig. V-18.


V-17


V-18

4. Me vija tregohet:

4.1. ndalimi kalimi për tramvaj – fig. V-19;

4.2. kalimi i lirë për tramvaj në kahun drejt- fig.V-20;

4.3. kalimi i lirë për tramvaj në kahun djathtas- fig. V-21;

4.4. kalimi i lirë për tramvaj në kahun majtas fig. V-22.






V-19 V-20 V-21 V-22

5. Shenja ndriçuese në vendkalimin hekurudhor:



PRISHTINË/A

5.1. Shenjat ndriçuese në vendkalimin hekurudhor (për shënimin e kalimit të rrugës mbi binarët e hekurudhës në të njëjtin nivel) mund të jenë shenjat për shënimin e barrierave dhe gjysmë barrierave si dhe shenjat me të cilat paralajmërohet ardhja ( afërsinë) e trenit gjegjësisht mbyllja e kalimit me barriera ose gjysmë barrier;

5.2. Përveç shënimit të vendkalimit hekurudhor me shenjat ndriçuese, kalimi duhet të sigurohet edhe me sinjale akustike.;

5.3. Nëse me shenjat ndriçuese në vendkalimin hekurudhor paralajmërohet ardhja e trenit, përkatësisht ulja e barrierave ose gjysmë barrierave, ku me këto shenja pjesëmarrësit në komunikacion lajmërohen mbi atë se barriera ose gjysmë barrierat janë në pozitën e mbyllur, këto shenja ndriçuese japin drita të kuqe alternative të cilat janë në formë të rrethit Ø 300;

5.4. Dritat nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të jenë të vendosura njëra pranë-tjetrës në shtyllën vertikale të tabelës e cila ka formën e trekëndëshit barabrinjës me maj të kthyer nga lartë, ngjyrat dhe dimensionet e të cilës i përgjigjen ngjyrës dhe dimensioneve të shenjave të rrezikut, gjatësia e brinjëve të trekëndëshit barabrinjës është me madhësi 120 (shenja VI-23), me ngjyrë retro reflektuese të klasës së III-të.



V-23

**SHTOJCA-VI**

## SHËNIMET NË RRUGË DHE NË SIPËRFAQE TJERA

1. Shenjat (shënime) gjatësore në rrugë janë:

1.1. Vijat gjatësore janë të plota, të ndërprera, të dyfishta dhe vija anësore.

1.2. Vija e plotë gjatësore (ndarëse dhe anësore) shënon ndalim kalimin e mjeteve përtej asaj vije ose ndalim lëvizjen të mjeteve në atë vije.

1.3. Përjashtimisht nga nënparagrafi 1.2 i këtij paragrafit lejohet tejkalimi i mjeteve në vijë të plotë të mjeteve që në rrugë të rrafshët nuk mund të zhvillojnë shpejtësi më të madhe se 30 km/h, dhe mjeteve qe nuk konsiderohen automjete.



VI-01

1.4. Vija gjatësore e ndërprerë mund të jetë vijë ndarëse, vijë ndërprerës e shkurtër, vijë e ndërprerë e gjerë dhe vija paralajmëruese. Vija ndërprerës ndarëse e ndanë sipërfaqen e rrugës në shirita të trafikut figura-VI-02.



VI-02

1.5. Vija e gjerë me ndërprerje shërben si vijë anësore për ndarjen e rrjedhjes së trafikutnë kryqëzime në rrugët jashtë zonave urbane dhe është me gjerësi së paku prej 30 cm.

1.6. Vija paralajmëruese shërben për paralajmërimin e afërsisë së vijës së plotë ndarëse fig.V-03.



VI-03

1.7. Vija e shkurtër me ndërprerje shërben si vij ndarëse në afërsi të degëzimit të kryqëzimit si vijë udhëheqëse në kryqëzim dhe për ndarjen e shiritave të trafikut për mjetet e transportit publik për udhëtar fig. VI-04.



VI-04

1.8. Vija ndarëse e dyfishtë mund të jetë vijë e plotë, vijë e dyfishtë e ndërprerë dhe vijë e dyfishtë e kombinuar.

1.9. Vija ndarëse e dyfishtë e plotë ndalon kalimin e mjeteve mbi ato vija ose ndalim trafikun e mjeteve nëpër ato vija dhe aplikohet patjetër në rrugët me trafik në dy drejtime fig.H05:

1.9.1. me dy ose më tepërt shirita të trafikut për se cilën kahe;

1.9.2. me numër tek të shiritave të trafikutnë qoftë se tejkalimi ndalohet në dy kahet;

1.9.3. në tunele ose afër tuneleve në gjatësi së paku 200 m;

1.9.4. në objekte;

1.9.5. nëse këtë e kërkojnë kushtet e trafikutdhe të sigurisë në rrugë ose rrethina e rrugës.



VI-05

1.10. Vija ndarëse e dyfishtë me ndërprerje shërben edhe për shënimin e shiritave të trafikut me kahje të ndryshueshme të lëvizjes në të cilat trafiku drejtohet  me shenja ndriçuese -fig. V-06.



VI-06

1.11. Vija e dyfishtë e kombinuar shërben për ndarjen e shiritave të trafikut në vendet në të cilat kushtet e dukshmërisë janë të tilla që lejojnë tejkalimin vetëm në një kah të lëvizjes- fig. VI-07.



VI-07

1.12. Pjesët e rrugës në afërsi të qaf malit, kryqëzimit, kalimit të rrugës mbi binarët e hekurudhës në nivel dhe në zonë urbane në të cilat dukshmëria (shikueshmëria ) e rrugës është dukshëm e zvogëluar mund të shënohet me një ose dy vija paralele të pandërprera të plota ose vija të dyfishta, nga të cilat njëra është e plotë, dhe tjetra e ndërprerë figura VI-08, VI-09 dhe VI-010.

1.13. Gjatësia ndërmjet pikës B dhe C (fig. VI-08) përcaktohet nga shpejtësia e lejuar, kështu që kalimi nga dy shirita në një shirit të trafikut aplikohet sipas:

n £ 1:60 për v > 50 km/h

n < 1:30 për v £ 50 km/h




*L-Gjatësia e shikushmërisë*
*M-(A-B,C-D)-Gjerësia e shikushmërisë*
*H-Lartësia e shikushmësisë*

VI-08




VI-09




VI-10

1. 14.Për përcaktimin e gjatësisë së dukshmërisë merret shpejtësia e cila nuk e tejkalon 85 % të mjeteve ose shpejtësia e llogaritur nëse vlera e të cilës është më e madhe.

1.15..Gjatësia e dukshmërisë (M) përcaktohet sipas shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve (fig. VI-09 dhe VI-10) është:

1.15.1. ...........130 km/h - nga 200m deri 400 m;

1.15.2. ......... 100 km/h - nga 160 m deri 320 m;

1.15.3. .......... 80 km/h - nga 130 m deri 260 m;

1.15.4. ........... 60 km/h - nga 50 m deri 100 m;

1.16. Gjatë përcaktimit të gjatësisë së dukshmërisë për shënimin e shenjave të rrugës në afërsi të qaf malit, në kthesë me dukshmëri të zvogëluar ose në vende të ngjashme, lartësia e syve është 1.0 m, ndërsa lartësia e objektit është 1.1 m.

1.17. Vija ndarëse e plotë duhet ti paraprijë vijës paralajmëruese (L) e cila përcaktohet sipas shpejtësisë së mjeteve të cilat vijnë dhe është së paku.

1.17.1. .......130 km/h - 160 m;

1.17.2. ........100 km/h - 120 m;

1.17.3. ........ 80 km/h - 100 m;

1.17.4. ........60 km/h - 80 m;

1.17.5. ........40 km/h - 60 m.

1.18. Shenjëzimi i vijës paralajmëruese mund të jetë i plotësuar me një ose më shumë shigjeta (VI-26), të cilat shoferëve iu tregojnë se cilin shirit të trafikut duhet shfrytëzuar.

2. Shenjat e tërthore në rrugë janë:

2.1. vija e ndalimit;

2.1.1. Vija e ndalimit mund të jetë e plotë ose e ndërprerë dhe atë. Vija e ndalimit e plotë shënon vendin ku shoferët detyrohen ta ndalin mjetin, para vijës të ndalimit në rrugë mund të shkruhet “STOP”- fig. VI-11;




VI-11

2.1.2. Vija e ndërprerë e ndalimit shënon vendin në të cilin shoferi duhet të ndal mjetin nëse është e nevojshme të lëshoj mjetet të cilat lëvizin në rrugën me përparësi kalimi. Para vijës të ndalimit mund të shënohet trekëndëshi paralajmërues.(VI-12);

2.1.3. Në vend të vijës së ndërprerë ndalëse, vendi në të cilin shoferi duhet të ndal mjetin në qoftëse është e nevojshme të lëshojë mjetet të cilët lëvizin në rrugën me përparësi kalimi mund të shënohet me trekëndësh me maje të kthyer kah shoferi (fig. V- 13);



VI-12



V-13

2.2. vija e pjerrët;

2.2.1. Vijat e pjerrëta shënojnë vendin e hapjes së shiritit dalës (fig. VI-14) dhe mbylljes së shirit hyrës (fig. VI-15) në auto udhë dhe moto udhë.




Fig.VI-14




VI-15

2.2.2. Hapja dhe mbyllja e shiritit të trafikut i destinuar për mjetet e transportit publik të udhëtarëve (fig. VI-16).



VI-16

2.3. kufizuesit;

2.3.1. Kufizuesi shënon vendin e hyrjes në të cilin është e nevojshme ndarja e pjesës së rrugës ku është i ndaluar trafiku (fig. VI-17).



VI-17

2.4. vendkalimi i këmbësorëve;

2.4.1. Vendkalimi i këmbësorëve përcakton pjesën e rrugës të destinuar për kalimin e këmbësorëve (fig. VI-18).

2.4.2. Në vendet në të cilat kalimi i këmbësorëve nuk mund të shënohet me ngjyrë, kalimi mund të shënohet me elemente çeliku ose plastike, kona ose shenja retro-reflektuese.



VI-18

2.4.3. Kur në rrugë është i shënuar vendkalimi për këmbësor (fig. VI-18), duhet të jetë i shënuar shenja III-02 dhe shenja I-33 (vendkalim i shënuar për këmbësorë), përveç në vendet ku trafiku rregullohet me shenja ndriçuese (semafor) dhe në afërsi të kryqëzimit ku ekziston vendkalimi i shënuar me shenja në rrugë dhe me shenja II-01 ose II-02.

2.4.4.. Në rrugë ku vendkalimi i këmbësorëve është në afërsi të shkollës duhet të jetë mbishkrimi >>SHKOLLA<< (fig. VI-55).

2.5. Kalimi i shtegut të biçiklistëve përtej rrugës është pjesa e sipërfaqes së rrugës qarkulluese e destinuar për kalimin e biçiklistëve (fig. VI-19).



VI-19

3. Me shigjeta mund të shënohen:

3.1. një kahje – fig. VI-20;

3.2. dy kahje (të kombinuara)-fig. Vi-21 dhe VI-22;

3.3. rreshtimi në dy kryqëzime e afërta ku rreshtimi duhet të kryhet para kryqëzimit të parë në të cilin është i ndaluar kthimi në kahjen e treguar -fig. VI-23;

3.4. kahja e lëvizjes për garazha -fig. VI-24;

3.5. kthimi i trafikut-fig. VI-25;

3.6. paralajmërimi i përfundimit të tejkalimit -fig. VI-26.



VI-20 VI-21 VI-22



H23



H24



VI-25



VI-26

4. Fusha për orientimin e trafikut shënon sipërfaqen në të cilën është i ndaluar trafiku dhe ndalja e mjeteve dhe atë :

4.1. në mes të dy shiritave me kahe të kundërta – fig. VI-27;

4.2. në mes të dy shiritave të kahut të njëjtë – fig. VI- 28;

4.3. në vendet e hapjes së shiritit të veçant për kthim – fig. VI-29;

4.4. përpara ishujve për ndarjen e rrjedhës së trafikut– fig. VI-30; VI-31,dhe VI-32;

4.5. në krahun hyrës të auto udhës - fig. VI-33;

4.6. në krahun dalës të auto udhës – fig. VI-34.



VI-27



VI-28



VI-29



VI-30



VI-31



VI-32



VI-33



VI-34

5. Vija për orientim shënon vendin e ndryshimit të sipërfaqes së lirë të rrugës para pengesave të forta të cilat gjenden në rrugë ose në skajet e tyre.

6. Vijat për orientim mund të jenë para ishujve për rreshtimin e mjeteve të transportit publik të udhëtarëve (fig. VI-35), për formën e pengesave në skajet e rrugës (fig. VI-36) si dhe për shënimin e ndryshimit të sipërfaqes së rëndësishme të rrugës (fig.VI-37).



VI-35



VI-36



VI-37

7. Mbishkrimet në rrugë, pjesëmarrësve në trafik i japin informata të nevojshme për shembull me fjalët >>STOP<<, >>BUS<<, >>TRAM<<,>>TAXI<<, >>SHKOLLA<<, >>TRENI<<, por edhe emërtimet e vendeve, kufizimi i shpejtësisë etj.(fig. VI -38, VI- 39, VI- 40, VI -41, VI -42, VI- 43, VI -44, VI -45, VI -46, VI -47, VI -48, VI- 49,dhe VI-50).




VI-38




VI- H39




VI-40




VI-H41




VI-42




VI-43




VI-44




VI-45



VI-46




VI-47



VI-48



VI-49



VI-50

8. Mbishkrimet në rrugë mund të vendosen edhe si shenja të trafikut (fig. VI-45, VI-46, VI-47).

9. Shënimi i sipërfaqeve të trafikut për nevoja të veçanta shërben për shënimin e vendeve të destinuara vetëm për vend ndalje të autobusëve (fig. VI-51, VI-52 dhe VI-53), shënimin i vendeve të destinuara vetëm për auto - taxi (VI-54 ), shënimin e vendkalimit për këmbësor në afërsi të shkollave (VI-55 ), shënimin e vendeve të destinuara vetëm për persona me aftësi të kufizuara (fig. VI-56), shënimin e vendeve ku është i ndaluar parkimi dhe ndalja (figura VI-57 dhe VI-58) si dhe shënimin e shtegut për biçiklist dhe këmbësor (VI-59).

VI-




51

VI-




52




VI-53




VI-54




VI-55



VI-56



VI-57




VI-58




VI-59

10. Shënimi i vendeve për parkim të mjeteve shërben për shënimin e hapësirave për parkim. Parkimi në raport me skajin e rrugës mund të jetë për së gjati (fig. VI-60), pjerrtas (fig. VI-61), dhe vertikal (fig. VI-62).

VI-60  VI-61  VI-62 



VI-63

11. Shënimi i mjeteve për ngadalësimin e trafikut- gungat artificiale në rrugë (fig. VI-63) dhe sipërfaqet e ngritura (VI-64).



VI-64

12. Elementet- konstruksionet dhe pajisjet e rrugëve publike dhe objektet të cilat nënkuptojnë pengesa të përhershme brenda madhësisë së profilit të trafikut shënohen kuq e bardhë, ndërsa profili i lirë bardhë e zi shenjat figura VI-65.



VI-65

13. Vija evakuese në mbështjellësin e tunelit shënohet gjatë gjithë gjatësisë së tunelit në anën të cilën janë hyrjet e zonave të kalimit të këmbësorëve dhe kalimet për mjete, me vij të gjerësisë 50 cm në ngjyrë të kuqe (RAL2002) – fig. VI-66.



VI-66

14. Vija evakuese në mbështjellësin e tunelit bëhet ashtu që skaji i poshtëm i vijës të jetë në lartësi prej 90 cm nga niveli i korridorit të këmbësorëve.

## SHTOJCA VII

## PAISJET RRUGORE

1. Pajisjet për shënimin e skajeve të rrugës janë:

1.1. kahja e treguesit (fig. VII-01) shërben për shënimin e skajit të rrugës;

1.2. shtylla e kahjeve të tregueseve në kahjen e drejtimit të lëvizjes duhet të ketë shenjën retro -reflektuese nga xhami retro – reflektues;

1.3. shenja retro reflektuese në kahjen e lëvizjes nga ana e djathtë është ngjyrë e kuqe, ndërsa nga ana e majtë është ngjyrë e bardhë;

1.4. në rrugët me një drejtim të lëvizjes shenja retroreflektuse është nga të dyja anët ngjyrë të kuqe;

1.5. kahje e treguesit - (VII-01), në parim vendoset në distancë prej 0,75 m nga skaji i rrugës, përgjatë rrugës në largësi prej 50 m kur rruga është e drejt, ndërsa 25 m kur rruga është në kthesa dhe varet nga rrezja e kthesës, përkatësisht sipas tabelës së paraqitur;

1.6. në autostrada dhe rrugë të rezervuar për mjetet motorike kahje treguesit (VII-01) vendosen në lartësi prej 105 cm, ndërsa në rrugët tjera në lartësi prej 0.90 cm nga niveli i sipërfaqes;

1.7. Kur përgjatë rrugës vendoset rrethoja mbrojtës zbutëse, kahjet e treguesit vendosen:

1.7.1. në rastet kur rrethoja e mbrojtësit zbutës është i larguar nga skaji i rrugës 1.5 metra dhe në rrethojat e vogla;

1.7.2. në raste kur rrethoja mbrojtëse me material të butë është e larguar më tepër se 1.5 m. në distancë minimale 0.5 metra deri maksimalisht 0.9 m. prej skajit të jashtëm të rrugës;

1.7.3. në raste kur rrethoja mbrojtëse me material të butë është e vendosur në shiritin ndarës në distancë prej 1.6 m e më pak, shtyllat e kahjes të treguesit vendosen në rrethojë.



VII-01

1.8. kahjet e treguesit, shenjat për tunele dhe galeri (fig. VII-02), shënojnë skajin e rrugës në tunel përkatësisht në galeri, dhe punohen me teknologjinë e diodave ndriçuese (LED) dhe duhet të ketë furnizim të përhershëm me energji;

1.9. kahjet treguese për tunele në kahjen e lëvizjes në anën e djathtë janë me ngjyrë të kuqe, ndërsa në anën e majtë ngjyrë të bardhë;

1.10. në rrugë me trafik me një drejtim shenja reflektuese në kahen e lëvizjes nga ana e djathë është ngjyrë të kuqe me prapavijë të bardhë, ndërsa nga ana e majtë është nga dy anët e punuar me ngjyrë të kuqe për raste të drejtimit të trafikut dhe shfrytëzimin e shiritit për trafik në dy kahe;

1.11. në tunele dhe galeri shenjat e kahjes lëvizëse janë në teknologji të diodave ndriçuese (LED) (fig. VII-02) vendosen në distancë 25 m kur tuneli ose galeria janë të drejta përkatësisht në distancën 15 m në kthesa dhe në 100 m para të tunelit ose galerisë;



VII-02

1.12. shenjat reflektuese (fig. VII-03) përcaktojnë skajin e rrugës të cilat vendosen në objekte në ve ndet në të cilat nuk është e mundur të vendosen në shtylla, forma, madhësia dhe ngjyra, varen nga vendi i vendosjes (në rrethojën mbrojtës, në pjesët anësore të tunelit, në muret mbajtëse ose ngjashëm si dhe në shenjat gjatësore dhe tërthore të rrugës);

1.13. sipërfaqja e shenjës reflektuese duhet të jetë e klasit III retro-reflektuese;

1.14. kur në rrugë është e vendosur rrethoja mbrojtëse nga betoni dhe në te vendoset shenja reflektuese (VII-03) në distancën e caktuar dhe në të njëjtën lartësi sikurse edhe në shtyllat e kahjet e tregueseve (VII-01);



VII-03

1.15. shtyllat për borë në kushtet e dimrit tregojnë skajin e shiritit rrugorë dhe shënojnë zgjatjen e rrugës ose objekteve rrugore;

1.16.shtyllat për borë në rrugë (fig. VII-04) dhe objekte rrugore (fig. VII-05) janë të ngjyrosura në mënyrë alternative ngjyrë të kuqe dhe të verdhë. Fusha më e lartë duhet të jetë e lyer me materie reflektuese;

1.17. shtyllat për borë (VII-04) vendosen në skaje të rrugës ku janë të vendosura edhe shtyllat e kahjes së tregueseve. Vendosja nga ana e djathtë e shtyllës së kahjes të tregueseve, shikuar në kahjen e lëvizjes ashtu që mos mbulohet pjesa reflektuese e kahjeve të tregueseve;

1.18. shtylla për borë duhet të vendoset para dhe në fund të rrethojës mbrojtës;



VII-04

1.19. në fillim të objektit rrugor vendoset shtylla me kufizues të kthyer nga poshtë, ndërsa në fund të objektit rrugor shtylla me kufizues të kthyer nga lartë;

1.20. maja e kufizuesit duhet të jetë e ngjyrosur me materie reflektuese.



VII-05

1.21. Tabelat për shënimin e ishullit (fig. VII-06, VII-07, VII-08 dhe VII-09), shënojnë majën e ishullit të trafikut në kryqëzime, në maje të ishullit ndarës në krahët dalës të auto udhës dhe moto udhë. Tabela VII-08 punohet si element hapësinor:

1.21.1. ngjyra bazë e shenjës VII-09 është e verdhë - kuqe ngjyra retro-reflektuese të klasit III-të.

VII-06  VII-07 

VII-08  VII-09 

2. Pajisjet, shenjat dhe shënimet për njoftimin e punimeve, pengesave dhe dëmtimin e rrugës janë:

2.1. tabela për shënimin e pengesave në anën e majtë të rrugës (fig. VII-10) dhe në anën e djathtë të rrugës (fig. VII-11) në drejtimin e ngasjes tregon punët ose pengesat në rrugë, në objekte dhe në sipërfaqe tjera të trafikut;

VII-10 

VII-11 

2.2. tabela për shënimin e kthesës në rrugë (fig. VII-12 dhe VII-13) dhe tabela për shënimin e kthesave të ashpra në rrugë (fig. VII-14) me kahjen e udhëzimit në të majtë ose në të djathtë;

2.3. ngjyra e shigjetës në shenjën VII-14 është me ngjyrë të verdhë dhe të kuqe retro-reflektuese të klasit të III-të;

2.4. shenjat vendosen në vendin ku fillon kthesa e ashpër, tabela VII-14 vendoset në kthesa të ashpra dhe të pa pritura;

VII-12 

VII-13  VII-14 

2.5. tabela (anësore) e pengesës (fig. VII-15, VII-16, VII-17, VII-18) shënon vendin anësorë që zvogëlon profilin e rrugës. Me tabelat fizikisht ndahen shiritat rrugor të kaheve të kundërta të lëvizjes. Tabelat: VII-17 e VII-18 vendosen edhe në vendet ku janë sipërfaqet e ngritura të rrugës ose gunga artificiale në rrugë;

2.6. ngjyra e shiritave të pjerrët në shenjat VII-17 dhe VII-18 janë verdhë e kuq retro-reflektuese të klasës së III-të;



VII-15 VII-16 VII-17 VII-18

2.7. konat kufizuese (fig. VII-19) shërbejnë për shënimin e punimeve në rrugë me kohë zgjatje të shkurtë;

VII-19 

2.8. rrethoja për shënimin e pengesave në rrugë (fig. VII-20 dhe VII-21) shërben për shënimin e pengesave në sipërfaqen e trafikut;



VII-20 VII-21

2.9. tabela për shënimin e vendit ku kryhen punimet në rrugë ose të dëmtimeve në rrugë (fig. VII-22 dhe VII-23);

VII-22  VII-23

2.10. tabela lëvizëse me dritë vezelluese dhe shenja (fig. VII-24 dhe VII-25) shënon vendin e punimeve në rrugë ose dëmtimin e rrugës;



VII-24 VII-25

2.11. tabela lëvizëse me drita vezulluese dhe shigjeta ndriçuese të kthyera poshtë dhe shenjën e trafiku (fig. VII-26) shënon vendin në rrugë ku shiriti i trafiku është i mbyllur, me te cilat trafiku orientohet;



VII-26

2.12. tabela ndriçuese lëvizëse me përmbajtje të ndryshuar (fig. VII-27, VII-28 dhe VII-29) paralajmëron vendin ku kryhen punimet ose ku është dhënë kahja dhe mënyra e orientimit të trafikut.




VII-27




VII-28




VII-29

3. Shenjat ndriçuese për shënimin e punimeve, e pengesave si dhe të dëmtimeve në rrugë:

3.1. diametri i dritave nuk duhet të jetë më i vogël se 210 mm. Distanca në mes dritave varësisht nga situata është prej 5 m deri në 10m.

3.1.1. drita e kuqe përdoret në tabelat për shënimin e pjesës së mbyllur të rrugës (Fig. VII-30);



VII-30

3.1.2. drita e verdhë vezulluese përdoret për theksimin e shenjës së trafiku mbi të cilën është e vendosur (fig. VII-31). Kur është fjala për shenjën, të drejtuarit dhe mbikëqyrjen e trafikut që shfrytëzon policia, atëherë në vend të dritës me ngjyrë të verdhë vezulluese përdoret drita me ngjyrë të kaltër vezulluese;


VII-31

3.1.3. vargu i dritave të verdha ndriçuese janë të lidhura të cilat në intervale kohore ndizen dhe fiken në mënyrë alternative në drejtim të lëvizjes. Vargu i ndriçueseve njofton se një ose më shumë shirita lëvizës janë mbyllur për lëvizje dhe që trafiku orientohet sipas " udhëtimit me drita" (fig. VII-32);


VII-32

4. Në pajisjet për udhëheqje dhe orientimin e trafiku në zonat e punimeve në rrugë, pengesave tjera si dhe dëmtimeve në rrugë janë:

4.1. skajoret e montuara të cilat shërbejnë për drejtimin e trafiku të mjeteve nëpër shirita të trafiku janë me ngjyrë të verdhë;

4.1.1. në skajore duhen të jenë të ngjitura shenjat reflektuese për dukshmeri më të mirë natën dhe në kushtet e dukshmërisë së zvogëluar (fig. VII-33).


VII-33

4.2. Markeret për ndarjen e kahjeve të ngasjes vendosen në rastet kur trafiku zhvillohet në dykahje nëpër rrugën njëdrejtimëshe:

4.2.1. sipërfaqja e markerve duhet të jetë me shenja reflektuese (fig. VII-34, VII-35 dhe VII-36);

4.2.2. markeri mund të jetë i pavarur ose i përforcuar në anësorë të montuar. Kur markerët janë të përforcuar në skajore montuese duhet të jenë ngjyrë të kuqe dhe të bardhë të drejtuar me maje teposhtë në drejtim të lëvizjes (fig. VII-K35 dhe VII-36).



VII- 34 VII-35 VII-36

4.3. Shenjat me kahje treguese për ndarjen e kaheve të lëvizjes dhe shënimin e kalimit të këmbësorëve si dhe kalimit të rrugës mbi binar të hekurudhës (fig. VII-37):

4.3.1. shenjat e kahjeve treguese (markerat) kanë shenja reflektuese orientuese ose shenja ndriçuese nga dy anët me ngjyrë të bardhë;

4.3.2. shenjat e kahjeve treguese për ndarjen e shiritave të trafiku në tunele (galeri), vendosen në distancën 6 m në rastin kur trafiku është në dy kahe në tunele, përkatësisht në distancën 12 m kur trafiku është në një drejtim.

VII-37 

4.4. perdet dhe shiritat shërbejnë për kufizimin e sipërfaqeve të vogla (fig. VII-38);

VII-38 

4.5. rrethoja ndarëse (pengesat elastike), bëjnë ndarjen fizike të sipërfaqes të paraparë për trafikun nga kahja e kundërt dhe sipërfaqe të rrugës ku trafiku është i ndaluar (fig. VII-39).

VII-39 

4.6. rrethoja elastike ( zgjerohen – ngushtohen) për mbylljen e sipërfaqeve të vogla lëvizëse (fig. VII-40 dhe VII-41).



VII-40



VII-41

4.7. Barrierat dhe gjysmë barrierat, janë mjete të desitunara për mbyllje të trafikut të mjeteve dhe këmbësorëve në kahjen ku ato janë të vendosur tërthorazi.

4.7.1. Në barriera drita e kuqe vezulluese vendoset në mesë të mbrojtësit, ndërsa në gjysmë barriera në fund të tij;

4.7.2.Diametri i rrethit të dritës ndërprerës minimum është 210 mm;

4.7.3. Barrierat të cilët janë të vendosur në vendkalimin hekurudhor të cilat e mbyllin rrugën përgjatë tërë gjerësisë së saj (fig. VII-42) duhet shënuar së paku me tri drita të kuqe me xham reflektues prej të cilave njëra duhet të vendoset në mes të barrierave, ndërsa dy tjerat në skajet e barrierës;



VII-42

4.7.4. Gjysmë barrierat në vendkalimin hekurudhor mbyllin trafikun vetëm deri te mesi i gjerësisë së rrugës (fig. VII-43). Duhet shënuar të paktën me tri drita të kuqe reflektuese të vendosura në distancën e caktuara gjatë tërë gjatësisë së gjysmë barrierës prej të cilëve njëri duhet të vendoset në fundin e gjysmë barrierës;



VII-43

4.7.5. Kur barriera dhe gjysmë barriera vendosen në hyrje të vend parkingjeve ose garazhave janë të ngjyrosura me të kuqe dhe sipas mundësive të shënuara me një xham reflektuese ngjyrë të kuqe;

4.7.6. Barriera dhe gjysmë barriera duhet të jenë të shënuara me xhama ngjyrë të kuqe reflektues edhe nëse janë të shënuara me shenja të veçanta të dritë pa ndërprerje ose vezulluese;

4.7.7. Xhamat reflektues nga paragrafi 1dhe 2 të këtij neni duhet të kenë sipërfaqe të paktën 40 cm duhet të vendosen ashtu që të duken nga kahja e rrugës ku trafikumbyllet;

4.7.8.. Barriera dhe gjysmë barriera duhet që gjatë tërë gjatësisë të jenë të mbështjellura me materie retro-reflektuese të klasit të II-të;

4.7.9.Pasqyrat e trafiku janë të destinuara për kyçje të sigurt nga rruga anësore në rrugë me përparësi kalimi ose në situata të ngjashme në vendet me dukshmëri të zvogëluar;

4.7.10. Skaji i jashtëm i pasqyrës së trafiku duhet të jetë i ngjyrosur alternativisht me fushë ngjyrë të kuqe dhe të bardhë;

4.7.11. Pasqyrat e trafiku mund të jenë të formës drejtkëndëshe ose rrethore (fig. VII-44 dhe VII-45).



VII-44



VII-45

4.8. Rrethoja mbrojtëse është konstruksion teknik për siguri, qëllimi i së cilës është parandalimi i rrëshqitjes së mjeteve nga rruga respektivisht të mos lejon mjetin të dal nga rruga.

4.8.1. Klasa e rrethojave mbrojtëse varet nga kategorizimi i rrugëve:

Tabela 1: Klasa e rrethojave mbrojtëse

| KATEGORIT E RRUGËVE | SKAJ I RRUGËS | SHIRITI NDARËS | OBJEKTI |
|---|---|---|---|
| AUTO UDHA- MOTO UDHA | H2- H1 | H2 | H3-H2 |
| RRUGËT NACIONALE DHE RAJONALE | H1 | | H2 |
| RRUGËT TJERA | N2 | – | H1 – H2 |

4.9.Gjatë punimeve në rrugë punëtori mbanë flamurin e kuq (fig. VII- 46) ndalim kalimi, ndërsa flamuri i gjelbër (fig. VII-46) kalim i lejuar. Flamuri i kuq dhe i gjelbër janë të madhësisë 40x40 cm.




VII-46 VII-47

4.10. Tabela rrethore me diametrit 30 cm e cila në një anë ka shenjën B04 (ndalim trafikunë një kahje fig. VII-48), në anën tjetër fusha e gjelbër me rreth të bardhë dhe gjerësi 6 cm (fig. VII-49). Shenja II-04 e kthyer nga ardhja e mjetit do të thotë ndalim kalimi (fig. VII-48) ndërsa fusha e gjelbër e rrethuar me të bardha e kthyer nga ardhja do të thotë kalimin e lirë (fig. VII-49).




VII-48 VII-49

4.11. Shenjat dhe pajisjet e rrugëve për qetësimin e trafiku ndikojnë në zvogëlimin e shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve deri në shpejtësinë e lejuar.

4.11.1. Shenjat dhe pajisjet për qetësimin e trafiku përmbajnë:

4.11.1.1.vija e bardha optike paralajmëruese;
4.11.1.2. shiriti për paralajmërim akustik (zërit);
4.11.1.3. shiritat vibruese (dridhëse);
4.11.1.4. gungat artificiale;
4.11.1.5. sipërfaqet e ngritura në rrugë.

4.11.2. Vija e bardhë optike paralajmëruese punohet me ndihmën e mjeteve për punimin e shenjave në rrugë, ndërsa ato akustike ose shiritave dridhës me frezim të sipërfaqes së vrazhdë në rrugë ose me mbartjen e shtresës së hollë në rrugë;

4.11.3. Gungat artificiale janë të profilit konvekse, ndërsa sipërfaqet e ngritura në rrugë janë të profilit trapez të cilat duhet të dallohen nga sipërfaqja e rrugës sipas materialit dhe ngjyrës ashtu që dukën mirë natën dhe ditën.

4.11.3.1. Gungat artificiale dhe sipërfaqet e ngritura mund të vendosen vetëm në rrugët me vendbanime (lagjet e banuara) me të cilat i afrohen zonave në të cilat është i domosdoshëm zvogëlimi i shpejtë i lëvizjes së mjeteve për sigurinë e trafiku;
4.11.3.2. Përdorimi i gungave artificiale dhe sipërfaqeve të ngritura nuk është i lejuar në vendet në të cilat mjeti i ndihmës së shpejtë ka lëvizje të shpeshta ( në rrugë që shpie kah institucionet shëndetësore);

4.11.3.3. Gungat artificiale dhe sipërfaqet e ngritura duhet të shënohen me tabelë plotësuese IV-44 përkrahë shenjës së trafiku VII-34 (II-31 ose III-04) dhe shenjat e trafiku III-10 (gunga në rrugë), VII-17 dhe VII-18 (tabela për të shënuar pengesat anësore) dhe shenjave në rrugë. Sipërfaqet e tyre duhet të jenë nga materiali jo rrëshqitës dhe i shënuar me përbërje nga substancat me reflektim të vazhdueshëm dhe duke reflektuar në anën nga e cila i afrohet mjetit;

4.11.3.4. Gungat artificiale duhet të jenë mirë të vendosura në mbrojtësit e rrugës ashtu që të parandalojnë ndarjen e elementeve ose pjesëve të tyre. Në zonën e gungave artificiale dhe sipërfaqeve të ngritura duhet të kryhen masat e përshtatshme të kullimit të ujit.

4.11.4. Masat më të shpeshta të cilat aplikohen për qetësimin e trafiku në shirit janë:

4.11.4.1. Vijat e bardha optike e paralajmërojnë shoferin se duhet zvogëluar shpejtësinë e lëvizjes;

4.11.4.2. Vijat vendosen në seri më së paku katër shirita ngjyrë të bardhë reflektuese në mënyrë të tërthorët në kahjen e lëvizjes përgjatë gjerësisë së shiritit lëvizës, duke rritur gjerësinë e shiritave në distancën më të vogël. Vija e parë duhet të jetë e gjerë minimum 20 cm, ndërsa secilës vijë pasuese i shtohet nga 10 cm (fig. VII-50). Distanca në mes të vijave varet nga fillimi (psh. 80 km/h)si dhe shpejtësisë përfundimtare (psh.40 km/h) të cilën mjeti e arrin para pjesës së rrezikshme në rrugë (fig. VII-51);

4.11.4.3. Vijat e bardha optike vendosen para: kryqëzimeve, vendkalimeve të këmbësorëve, para pjesëve të rrezikshme të rrugës, para pllakës III-79 (emërtimi i zonës urbane) vendit ku bëhen pagesat në rrugë, kalimeve kufitare dhe ngjashëm.

VII-50





VII-51

4.11.5. Shiritat për paralajmërim me akustik për shoferët të cilët gjatë kalimit të mjeteve emitojnë dridhje të lehta me efekte akustike ku paralajmërohen shoferët se duhet të zvogëlojnë shpejtësinë e lëvizjes (fig. VII-52):

4.11.5.1. Shiritat punohen me gërvishtjen e sipërfaqes së shiritit me mjete sipërfaqësore, me gërvishtje ose hedhjen e granulit guror eruptivë të madhësisë 8 deri në 12 mm;

4.11.5.2. Shiritat akustik vendosen në qifte në largësi 1.8 m (2.0 m) mbi shiritin e trafiku, gjerësisë 20 deri në 40 cm dhe lartësisë 5 deri 12 mm, në distancë të ndërsjellët e cila varet nga shpejtësia më e madhe e lejuar (psh. 80 km/h) dhe shpejtësisë më të vogël të lejuar (psh. 40 km/h) të cilën mjeti e arrin para pjesës së rrezikshme të rrugës;

4.11.5.3. Shiritat akustik mund të vendosën para shkollave, çerdheve, vendkalimeve hekurudhore, vendkalimeve për këmbësorë, në vendet ku bëhen pagesat në rrugë, kryqëzime dhe kthesave të rrezikshme ku janë shpejtësitë e larta të lëvizjes dhe ku dëshirojmë që me zë dhe dridhje e vogla të mjeteve që t'ia tërheqim vërejtjen shoferëve se duhet të zvogëlojnë shpejtësinë sipas kufizimeve të parapara me rregulla apo me shenja në atë rrugë.




VII-52

4.11.6. Shiriti dridhës-vibrues i cili gjatë kalimit të mjeteve emitojnë dridhje të forta dhe efekte akustike, me këtë i paralajmëron shoferët se duhet të zvogëlojnë shpejtësinë. Shiritat janë të radhitura në qifte në largësi 1.8 m (2.0 m) njëri nga tjetri fig. VII-53:

4.11.6.1. Shiritat dridhës –vibrues punohen nga granulati gurorë eruptiv përgjatë gjithë gjerësisë së shiritit nga 20 deri 40 cm dhe lartësisë 18 deri 25 mm. Distanca e qifteve të shiritave varet nga shpejtësia më e larte e lejuar e cila në parim paraqet kalimin kohor prej një ose dy sekondave;

4.11.6.2. Shiritat dridhës-vibrues vendosen në vendet ku dëshirohet të paralajmërohet shoferi të ngas sipas kufizimeve të parapara për atë rrugë.




VII-53

4.11.7. Gungat artificiale janë elemente të ndërtimi të cilat vendosen para zonave për qetësimin e trafiku, në të shumtën e rasteve në rrugë dhe brenda zonave të banuara të shënuara me shenja të trafiku III-22 (zona në të cilën është shpejtësia e kufizuar) ose me shenjën III-26 (zona e trafiku të qetë ( fig. VII-54):

4.11.7.1. Gungat vendosen përgjatë gjysmë ose për gjatë tërë gjerësisë së shiritit të trafiku;

4.11.7.2. Nëse vendosen në varg distanca në mes gungave duhet të jetë 20 deri në 60 m varësisht nga situata;

4.11.8. Varësisht prej kufizimit të shpejtësisë dimensionet janë nga këto:

4.11.8.1. Për 50 km/h ose më pak gjerësia nuk mund të jetë më e vogël se 60 cm, lartësia nuk duhet të kaloj 3 cm;
4.11.8.2. Për 40 km/h ose më pak, gjerësia nuk duhet të jetë më e vogël se 90 cm, ndërsa lartësia jo më e madhe se 5 cm;
4.11.8.3. Për 30 km/h ose më pak , gjerësia nuk duhet të jetë më e vogël se 120 cm, ndërsa lartësia jo më shumë se 7cm;
4.11.8.4. Tip a) dhe b) duhet të punohen nga elementet modulare (guma dhe masa plastike) ndërsa tip c) mund të punohet nga masa e asfaltit;
4.11.8.5. Gungat janë të vendosura dhe të shtrira në drejtim të ngasjes dhe nuk lejohen të kenë maje.

VII-54




4.6.9. Sipërfaqet e ngritura janë elemente të ndërtimit të destinuara për zvogëlimin e shpejtësisë së lëvizjes. Punohen një nga një ose në vargë zakonisht në vendet që janë afër vendkalimeve për këmbësorë (fig. VII-55). Lartësia e sipërfaqes së ngritur është 7 deri 12 cm. Këndi i pjesëve fillestare të ngritura është në mes 1:10 deri 1:20, ndërsa gjatësia e afërsisë së barrierave varet nga lartësia e sipërfaqeve të ngritura dhe është me gjatësi minimale prej1 m.

VII-55

VII-55



**SHTOJCA VIII**

## SHENJAT DHE URDHËRATE POLICIT

1. Shenjat të cilat i japin personat e autorizuar (Polici), me duar dhe pozitë të trupit apo nga automjeti, për pjesëmarrësit në trafik janë paraqitur në vijim:

1.1.Dora e djathtë të ngritur vertikalisht me pëllëmbë të hapur dhe të kthyer në të majtë, do të thotë ndalim kalimi për të gjithë shoferët, përveç për ata shoferë të automjetit kur në momentin e ngritjes të dorës nuk munden të ndalen sigurt, ndërsa për këmbësor është ndalim për ta kaluar rrugën. Kjo shenjë e Policit përdoret vetëm në kryqëzim. (VII-1);



VIII-1

1.2. Me dorën e djathtë të ngritur vertikalisht me pëllëmbë të dorës të hapur të kthyer përpara, do të thotë ndalim për të gjithë shoferët ndaj të cilëve është kthyer pëllëmba e dorës dhe pozita e trupit (gjoksi). (VII-2).



VIII-2

1.3. Në dhënien kësaj shenje nga paragrafi 2 i këtij neni, zyrtari i policisë mund ta përdor dorën tjetër (në formë të shtrirë) për t'i treguar një shoferi të caktuar për të ndaluar automjetin e tij për kontrollin e sigurisë. Në rrugë të hapur mundet të përdoret tabela stop, ndërsa në kushtet e errësirës mund të përdoret bateria reflektuese. (VIII-3 dhe VIII-4).



VIII-3



VIII-4

1.4. Dora e djathtë e shtrirë horizontalisht me pëllëmbë të hapur në të majtë, do të thotë ndalim të kalimit për të gjithë pjesëmarrësit në trafik e cila kryqëzon drejtimin e dorës të ngritur. (VIII-5);



VIII- 5

1.5. Dora e shtrirë horizontalisht, duke e tundë lehtë dorën lart e poshtë, me pëllëmbë të hapur të dorës lartë - poshtë, do të thotë drejtimi në të cilin shoferit i jepet shenja duhet ta zvogëloj shpejtësinë e automjetit. (VIII-6);



VIII- 6

1.6. Dora e shtrirë horizontalisht, krahu i lakuar në bërryl, me dorën e hapur duke e lëvizur në mënyrë rrethore (në drejtim të rrotullimit të rrotave të automjetit), do të thotë se shoferi drejtimi i të cilit është dhënë kjo shenjë duhet të përshpejtojë lëvizjen e automjetit. (VIII-7);



VIII- 7

1.7. Dora e shtrirë horizontalisht me pëllëmbë të dorës të hapur duke treguar në drejtim të një automjeti apo të kolonës së automjeteve, do të thotë se shoferi i automjetit është i detyruar ta ndal mjetin. (VIII-8):

1.7.1. shenja nga nën paragrafi 1.7.i kësaj shtojce kjo shenjë jepet gjatë rregullimit të trafikut në kryqëzim.



VIII-8

1.8. Dora e ngritur horizontal me pëllëmbë të dorës të hapur të kthyer nga trupi në lartësi të kokës, me bërryl të lakuar, duke lëvizur para mbrapa, do të thotë që shoferi të cilit iu është dhënë shenja duhet të lëvizë mjetin e tij pranë kryqëzimit, ose zyrtarit të autorizuar të policisë i cili jep sinjal. (VIII-9);

1.1.1. Shenja nga nën paragrafi 1.8. i kësaj shtojce jepet gjatë rregullimit të trafikut në kryqëzim dhe në rrugë të hapur.



VIII- 9

1.9. Me trup në pozicion në këmbë të drejtë, ose në të njëjtën pozitë me dy duar të hapura horizontalisht, do të thotë se shoferët automjetit që vijnë nga drejtimi në të cilin atyre iu është kthyer gjoksi ose mbrapa shpinës së Policit, duhet ti ndalojnë makinat e tyre, dhe për shoferët të automjeteve që vijnë nga drejtimi i krahëve të hapura kanë të drejtën e kalimit. VIII- 10 dhe VIII-11.





VIII-10 VIII-11

1.10. Në rrugë të hapur, shenjat e përmendura jepen me kusht që zyrtari duhet të jep shenjën (plotësuese) shtesë me dorën tjetër për qëllim të tregimit se ku duhet vetura të ndalet, si dhe me shenja tjera reflektuese, bateri ose stop tabelë dhe jelek reflektues në kohën e errësirës.

2. Zyrtari i autorizuar (Polici) mund të japë shenjat në kryqëzim vetëm nëse ai është i vendosur në qendër të kryqëzimit.

2.1.shenja nga VIII- 1 deri VIII-8, të kësaj shtojce të këtij Udhëzimi Administrativ, mund të jepen nga Polici i cili është vendosur në vend tjetër të përshtatshëm në kryqëzim të rrugës, në qoftë se ky veprim është më efikas dhe më i sigurt për të rregulluar trafikun, me kusht që lehtësisht të vërehet nga pjesëmarrësit e trafikut të cilëve iu jepet shenja;

2.2.Nëse në kryqëzim disa polic të autorizuar ndihmojnë në rregullimin e trafikut, shenjat të cilat ata i japin duhet të jenë në përputhje me shenjat e dhëna nga Polici i cili është në qendër të kryqëzimit dhe të njëjtat duhen të koordinohen;

2.3.Në dhënien e shenjave, ndalimin e kalimit dhe ngadalësimit, përshpejtimin dhe lëvizjen e mjeteve, mund të jepet dhe në kombinim me tabelën për rregullimin e trafikut (në tekstin e mëtejmë tabelë Stop (VIII-12), ose në kushtet e errësirë me bateri ndriçuese (VIII- 13), si dhe në lëvizje nga automjeti zyrtar;

2.4.Tabela Stop është në formën rrethore me një diametër prej të paktën 11 cm dhe është e kapur në një mbajtës përkatës. Baza e brendshme e tabelës Stop është e ngjyrës së bardhë reflektuese, me rreth të ngjyrës së kuqe prej të paktën 2 cm, dhe ka mbishkrim: "STOP POLICE". (VIII-12).




**VIII-12**

3. Shenjat zanore të cilat jepen me bilbil ato duhet të kombinohen me shenja që i japin me dorë vetëm në rastin kur një zyrtar i policisë është jashtë automjetit, dhe kanë këto kuptime:

3.1.Një fishkëllim e zgjatur me bilbil, i referohet pjesëmarrëseve në trafik që e dëgjojnë atë, që të i kushtoj vëmendje policit të autorizuar i cili do të jep një shenjë ose veprim tjetër të radhës;

3.2.Me fishkëllima të njëpasnjëshme, do të thotë se disa nga pjesëmarrësit në trafik kanë vepruar në kundërshtim me shenja, rregullat e trafikut apo shenjave të trafikut të përcaktuar;

3.3.Shenja e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni do të jepet vetëm në rregullimin e trafikut në kryqëzim;

3.4.Shenjat e përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, zyrtari i autorizuar i policisë gjatë orientimit të trafikut është i obliguar ta tregoj dorën e tij për ti informuar pjesëmarrësit në trafik se cilin detyrim e kanë shoferët dhe pjesëmarrësit tjerë në trafik.

4. Drita e kuqe dhe kaltër, njëra prej të cilave është dritë e kaltër në të djathtë, dhe ngjyra e kuqe në anën e majtë të automjetit, kur ato ndizen, në kombinim me zërin e burisë me intensitet të ndryshueshëm (sipas nevojës), tregojnë:

4.1. se vetura e Policisë është nën përcjellje. (VIII-13)



VIII-13

4.2.për dukshmëri më të mirë të automjetit nën përcjellje, automjetit mundet ti ndezën dritat e gjata me ndërprerje të shkurta;

4.3.drita e kaltër e ndezur në automjetet zyrtare të Policisë, në kombinim me zërin e burisë me intensitet të ndryshueshëm (sipas nevojës), tregojnë automjetin me përparësi kalimi. (VIII- 14)



VIII-14

4.4. Në automjetet zyrtare të Policisë në pjesën e përparme dhe të pasme, mundet të vendosen drita në ekranin ndriçues dhe të japin mesazhe të shkruara që janë në funksion të kontrollit dhe rregullimit të trafikut, si p.sh: "Stop Policia", "Liro rrugën djathtas", “Kontrollo shpejtësinë”, “Ndiqni nga mbrapa", "Ngadalëso" ...etj. (VIII-15 dhe VIII-16)






VIII-15 VIII-16

4.5. Në rastet e veçanta, për qëllim të kontrollit të pjesëmarrësve në trafik, këto pajisje mundë të instalohen edhe në vetura zyrtare të Policisë të cilat janë me targa civile me kusht që zyrtaret Policor gjatë detyrës me këto vetura të janë në uniform të rregullt zyrtare;

4.6.Mesazhet në ekran janë të shkruara në gjuhën shqipe dhe serbe.